

# **FETAVATË E SHAËRAVIJUT**

## **PJESA E NËNTË**

### **IX**

**Përktheu: Dr.Musli Verbani**  
**Imam i QIKSHN-së**

**Oslo, 2010**

## HYRJE

Prof: Ali Abdul Adhim.

Këshilltar dhe ekspert I artit për në institutin e hulumtimeve islame.

Te shkruarit është art I ndërlikuar dhe më i përpiktë prej arteve ideare. Çdo ide nuk është e dobishme atë nuk është mire te shkruhet.

Përderisa idetë jan ushqim I mendjeve ashtu siq jan ushqimet ushqimi I trupit. Çdo ushqim nuk është I mire për trupin, por patjetër duhet parapërgatitur kushtet specifike qe e bene te dobishme për kryerjen e detyrës. Prej kushteve me te rëndësishëm jan: e Para: qe ta ngope (mbuloj) nevojën e mendjes, ashtu siq e ngop ushqimi nevojën e trupit. Llojllojshmëria e ushqimit e cila posedon proteinat ,vitaminat dhe kaloritë të gjitha këto bëjnë që ushqimi të jetë me I mirë dhe që kryen detyrën. Po ashtu idetë duhet te përmbajnë argumente logjike, dhe te kapshme për ta ngop mendjet e që gjithashtu duhet të ketë element nxitës që ta josh lexuesin e pastaj ai të përfitojë prej atyre ideve.

Kur Halil bin Ahmedi është pyetur derisa a është themelues I poezisë rimimit dhe rregullave diametrike te vargjeve ne fjali është pyetur për poezinë, ai është përgjigjur.

E mira mua më refuzon, ndërsa zemra ime të keqen po e refuzon. Kur është pyetur profesor Akadi se pse nuk martohet pasi qe ai ka nevojë për shoqërinë, dhe përkujdesje dhe jete me te mire është përgjigjur net e njëjtën mënyrë siq është përgjigjur Halili bin Ahmedi: për shkak se e mira me refuzon ndera te keqen zemra ime po e refuzon.

E dyta: Për t'i nxitur ndjenjat e lexuesit për t'i aktivizuar elementet e tretjes

Kur ai I cili dëshiron te ketë apetit ne ushqim, me ushqime te llojllojshme për ta ngopur veten nga me e mira dhe me ushqim sa me te mire, ai harmonizon ushqimin e llojllojshëm me nevojën e trupit I cili ka nevojë për ushqim te llojllojshme. Për këtë arsye ai ushqimit I shton lloj-lloj mëlmesa qe te jetë ushqim sa me I këndshëm I cili duhet te jete I lehtë për organet e tretjes.

E treta: Për këtë arsyes autori I librit, apo studiuesi duhet të tregojë literaturën e konsultuar të paraqes rëndësinë e librit sepse tërheqja e vëmendjes është prej qëllimeve kryesore të autoreve ose te studiuesve.

Nga kjo, urtësia e Allahut është se iu ka mundësuar disa studiuesve dhe hulumtuesve qe ato ide të tyre logjike t'i paraqesin ne formën sa me te mire, sa me tërheqëse per te pasur dobi prej atyre ideve.

Nëse i bëjmë një vështrim kulturës se grekeve te vjetër shohim se nuk do te kishim pasur dobi prej ideve te filozofit Sahrati po mos e kishte vazhduar rrugën e tij. Platoni i cili i ka ruajt dhe I ka paraqit idetë e Sokratit, e pastaj prej tij kane ardhur deri tek ne me metodën tërheqëse dhe bindëse.

Nuk do te kishim pasur dobi prej ideve te Platonit po mos të kishte vazhduar dhe mos t'i kishte përcjellë idetë e tyre Aristoteli, deri tek ne. Ai I ka ruajt qe te mos lihen me harrese dhe prej tij kane ardhur deri tek ne me metodën tërheqëse dhe bindëse.

Shembull te tille mund te marrim edhe me rastin e Ibni Tejmije si dijetarë islam me renome dhe nxënësin e tij Ibn Kajin el.xhevzijut I cili na ka sjell neve mendimet e profesorit te tij, dhe ka vazhduar rrugën e tij ne rizgjimin islam, dhe frytet e tij po I shijojmë tani. Po ashtu shembull kemi edhe Xhemuladin Afgani dhe nxënësin e tij Muhamed Abdahu dhe nxënësin e tij Reshid Rida. Po mos te kishte qene ai, gjurmët e profesorit te tij do të kishin humbur, dhe nuk do te kishim projektimin e rrugës per rizgjim te plot islam I cili ka sjelle rezultate te mira, e frytet e atyre rezultateve po I shijojmë edhe sot.

Këtë kjo çështje mu kujtua atëherë kur kam lexuar pjesë të librit „Fetvate” e imanit shejh Muhamed Muteveli esh. Shaeravijut te cilat I kanë përgatitur nxënësin e tij Mr. Sejid Xhemil. Sepse Shejh Shaeraviju është u njohur me mendje mprehtësi e tij ,dhe dhuntinë e tij.

Ai nuk ka pasur kohe qe ti rishikoj, kontrolloj dhe redaktoj por këtë ia ka mundësuar Allahu Sejid xhemil, dhe profesorit Ahmed Feraxh për t’i shpalosur gjurmët e Shejh shaeravijut, dhe paraqitjen e tyre ne formën më të mirë edhe më të lehtë.

Këtë e kam vërejtur atëherë kur kam lexuar artikujt e dr. sejid xhemil dhe kam pa përvojën e tij gazetaresë I cili është tërheqëse me metodologjinë e tij dhe depërtimin e tij thelle dhe fuqishëm ne kulturën dhe studimin islam ne mjekësinë praktike islame, me letërsi islame I cili me mund dhe durim te madh hulumton, tubon, I përzgjedhë dhe harmonizon idetë dhe mendimet.

Zoti I shpërbleftë me te mira shejhun tone imam shaeravijun për diturin e tij te dobishme I cili islamit dhe muslimanëve I ofron dituri te dobishme I cili islamit dhe muslimanëve u ofron dituri te dobishme. Zoti e bekoftë jeten e toj.

KAJRO: 7 sheval, 1402

28 korrik, 1982.

Ali Abdul Adhim

Këshilltar dhe ekspert i artit ne institutin për hulumtime islame.

## ARTET E BUKURA

Pyetje: Arti i bukur si pikturimi, skulpturimi e të ngjashme a janë të lejuara apo ndaluara?

Përgjigjja: Arti i bukur ,ti po e thua këtë ,ti po thua se është arti i bukur,por nga e more këtë qëndrim që ti ta cilësosh të bukur?A është cilësi me të cilën e ka emëruar feja? JO Prej njeriut? Ne parashtrijmë pyetjen:Çka do të thotë „i bukur"?Kusht është që e mira mos të shpie ty në të keqen.Thonë:Vallëzimi është art i bukurisë. Mirëpo vallëzimi a të shpie në të keqe apo jo?Çdo bukuri e cila rezulton(prodhon)të keqën nuk është e bukur. Për këtë arsye mos thuaj:„Arti i bukur".Por e cilëson të bukur atëherë kur pranohet e bukur. Po si të jetë e bukur kur nuk sjell asgjë tjetër pos të keqen!!

Skulptori e skulpturon një skulpturë. Kjo skulpturë është e bukur,po është e përkryer,përderisa tjerët devijojnë, dhe pas kësaj atë skulpturë e adhurojnë,pra kjo është e keqe. E mira është që të mbetet e mirë ,të mbetet në sy e mirë dhe në mendje e mirë. E jo e mirë në vetvete (vetëskulpturën).Allahu kërkon prej nesh që botën ta bëjmë të bukur. Çka do të thotë „e bukur",do të thotë me vazhduar të jetë gjithmonë të bukur(p.sh femra e cila zbukurohet që të jetë e bukur).Unë i them asaj: Bukurinë tënde bëre që të mos na shpijë neve në të keqe ,që të mos ti shkakton probleme familjes së saj,mos ti shkaktoj probleme burrit të saj ,mos u zbukuro vetëm të jesh e bukur por që bukuria jote të jetë gjithëpërfshirëse se përndryshe...Kur'ani para se të na sjell të mira të shumta materiale ,na sjell të mira të shumta të bukurisë. Thotë Zoti i Lartmadhëruar në Kur'an:Dhe për ju caktoj në ta (bagëti) ka bukuri,kur i ktheni nga kullota, dhe kur i merrni në kullotë. Ato mbajnë barrët tuaja deri në vende të largëta ,tek të cilat ju do të arrini me mundim të madh"(EN-NAHL6-7. Parashtrihet pyetja:Pse?

Sepse teorema e bukurisë është se edhe ai i cili nuk pronëson gëzohet,pra ai i cili nuk i pronëson gëzohet kur ti sheh. Unë nuk kam kështjellë por kur ta shohë një kështjellë të bukur dhe shoh parkun,oborrin rreth e përçark,gëzohem dhe bëhem i lumtur. Nga ky aspekt bukuria është çështje transitore ,që do të thotë kalon në të gjithë ata të cilët e shohin ,ndërsa sa i përket qumështit, bartjes së barrës është posaçërisht për ata që e pronësojnë.

Para se ti shoh frytet e pemëve Zoti i Lartmadhëruar thotë:„Shikoni në frytet e pemës para se të piqen plotësisht dhe të marrin formën e tyre"(EL -ENAM99). Kënaqni sytë e juaj duke shikuar e jo vetëm barqet e juaja.

Mirëpo ,më siguro se puna mbetet kështu. Mos thuaj se „arti i bukur në tërësi "sepse arti i bukur patjetër duhet ta ruaj bukurinë përgjithmonë ,e jo me qenë të bukur në një qastë,e të shkatërrojnë në çastin tjetër. Kjo nuk është „bukura".

P.sh. Skulptura nëse më sjell mua në idhujtari dhe në pabesim nuk është e lejuar. Para se të sprovohen njerëzit ajo veç ka qenë prezent, mirëpo pasi që ka kaluar në adhurim të tyre puna e tyre veç ka mbaruar. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë për Sulejmanin se: Sulejmani i ka nënshtruar xhinët ,që ata me ndërtuar çka dëshiron prej mihrabave ,skulpturave

Kanë ndërtuar skulptura dhe nuk ka ndodh shkatërrim prej tyre mirëpo nga çasti kur ka ndodhë fitnet dhe shkatërrimet ka thënë:JO,më nuk ndërtohen skulptura.

## **PSE ALLAHU E KA CAKTU QË SULEJMANI TË JETË MBRET**

Zoti i Lartmadhëruar ka dërguar peygamber të cilët nuk kanë qenë mbretër. kështu ka caktuar me urtësinë e tij , sepse po të kishte dashur Allahu që të gjithë me qenë peygamber askush nuk do ti kishte mund me penguar. Cila është urtësia e zgjedhjes së Sulejmanit edhe mbret edhe peygamber?

Përgjigjja: Nga kjo kuptohet qartë se po të donte Allahu që të gjitha çështjet do të shkonin në rregull,dhe askush nuk do të mund ta ngritte kokën. Dhe ja e ka zgjedh peygamberin të cilin nuk ka mund ta refuzon askush kërkesën e tij ,sepse ai ka poseduar pushtet dhe sundim. Mirëpo Allahu nuk ka dëshiruar kështu. Allahu dëshiron që të shkojmë në drejtimin e tij vullnetarë. Allahu dëshiron që të shkojmë në rrugën e Tij , edhe pse ata të cilët shkojnë në rrugën e tij janë të dobët. Kjo nga arsyeja se dashuria për Te na ka shty të besojmë

Sa e sa mundime kanë përjetuar peygamberët. Sa e sa urrejtje e sa e sa xhelozitë e fatkeqësi i kanë përjetuar në thirrjen e tyre në programin e Allahut!!!?

## **DHE NUK KA BËRË KUFËR (NUK KA KALUAR NË PABESIM) SULEJMANI**

Allahu ia ka nënshtuar Sulejmanit xhinët .Melekët ia kanë dërguar Sulejmanit xhinët me pranga të zjarrit,Sulejmani i ka dënuar ashpër nëse nuk kanë kryer urdhrin e tij.

Sulejmani nuk e ka përdorë magjinë në nënshtimin e xhinëve ai i ka përdorë ata për çështje të dobishme e jo për çështje të dëmshme.

Kur ka vdekur Sulejmani ata jan ngritë kundër tij duke thënë Sulejmani ju ka nënshtuar juve me magji dhe i kanë dërguar të vendi ku ka qenë i varrosur... hajmalia i kanë vendos edhe nën frontin e tij ashtu siq thuhet në disa shkrime të „israilëve".Kur'ani e shfaqëson Sulejmanin për këtë .Ku Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:„Dhe pasojnë atë çka kanë thënë shejtanët për sundimin e Sulejmanit, Sulejmani nuk ka qenë pabesimtarë por shejtanët kanë qenë pabesimtarë ata ua mësonin njerëzve magjinë".

Pyetja është: Çka mendon Shaëraviju në lidhje me këtë çështje ?

Imami i nderuar thotë:Allahu i Lartmadhëruar ia ka nënshtuar xhinët Sulejmanit për t'i sjell dobi njerëzimit,dhe për ta zhvillu tokën,e nuk i ka nënshtuar për ti dëmtuar. Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë „Dhe Sulejmani nuk ka qenë pabesimtarë që do të thotë se Zoti i Lartmadhëruar kur ka dëshiruar që Sulejmanit me ia nënshtuar xhinët ka qenë e ditur se Sulejmani nuk është pabesimtar, dhe këtë fuqi nuk e ka shfrytëzuar për të keq,por e ka shfrytëzuar fuqinë e tyre për të mirë,posaçërisht kur Allahu i jep dikujt diçka çka nuk u ka dhënë të tjerëve sepse mizoria dhe pabesimi e mbisundojnë botën posaçërisht kur e shfrytëzojnë këtë shans, për tu përhapur e keqja dhe mëkati. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar tregon për melekët Harut dhe Marut të cilët ua kanë mësuar njerëzve magjinë,,E nuk e kanë mësuar asnjë njeri pa i thënë:Vërtet ne jemi sprovë për ju e mos moho".Fjala „mos moho" do të thotë se nëse e ke në disponim një forcë të gjithësisë ruaju, ki kujdes e mos e shfrytëzo për asgjë tjetër pos për gjëra të dobishme. kjo praktikë duhet të jetë për çdo fuqi,pushtet,apo forcë të cilën ia jep Allahu kujtdoçoftë. Kur ti lutesh për diçka thua:Zoti im më jep këtë ,që të adhuroj me sinqeritet ,dhe të bëjë të mira në këtë botë. E kur Allahu ta jep atë (pushtet,pozitë apo forcë) ajo ty të nënshton dhe përkundrazi ti fillon me bë shkatërrime. P.sh. nëse ti do pushtet e lutë Allahun me të dhënë pushtet,Zoti ta pranon këtë lutje. E pasi që ti të arrish në pushtet fillon me sulmuar të drejtën, e përhapë shkatërrimin dhe padrejtësinë, duke menduar se ti mundesh me pengu Zotin e Lartmadhëruar. Ti kur je lut për mirësi a pasi që të është dhënë je

drejtuar në të keqe. Kështu Allahu na mëson sjelljet e shejtanit në zemrën e njeriut. Ti pasi të arrish në pozitë, të vjen shejtani dhe shkakton cytje në epshin tënd, ashtu siq e ka hamend zemrën e Ademit duke i thënë :pushteti yt nuk do të ket përfundim ti do të jesh i përgjithmonshëm, Allahu nuk do të kërkoj llogari ,e ti e harron ditën e llogarisë, e ti atëherë fillon me shkaktoar trazira e shkatërrime në fytyrën e tokës ,e kështu t'i humb pushtetin ,e humb autoritetin ,e takon Allahun të vetmuar ,i pafytyrë. Kështu Allahu ta ka humb shansin në të cilën e ke pasur në dorë ne vend se ti me qenë më i graduar ti bëhesh më i nënçmuari.

Për këtë arsye kur të fillosh me lexuar Kur'an, Allahu ka kërkuar prej teje me kërkuar mbrojtje prej Tij nga shejtani i mallkuar. PO pse? Nëse ti i mbështetesh Krijuesit kundrejt krijesës së Tij ajo krijesë nuk mundet me të shkatërruar. Kur ti e lexon Kur'anin ,shejtani nuk dëshiron që ti të përfitosh të mirat e Allahut prej leximit të Kur'anit. E kur ti kërkon mbështetje prej Allahut kundrejt shejtanit ,ai shtrydhet, Sepse që në çastin kur ti e kujton Allahun shejtani shtrydhet. Pra thënia e Allahut: Dhe kur ta lexosh Kur'anin ,kërko mbështetje kundrejt shejtanit të mallkuar thuhet se ti je bërë mjet për të pranuar rrezet e dritës së të mirave të Kur'anit pa kurrfarë pengese.

### **DHE SECILI PREJ JUVE DO TË SILLET NË TË**

Dhe Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: “Dhe secili prej juve do të sillet në të. Kjo çështje është vulosur”.

(MEJREM, 71)

A do të thotë se të gjithë njerëzit do të sillen në zjarr?

Imami i nderuar Shaëraviju thotë: Siç e interpretojnë disa komentues ky ajet tregon se askush nuk mund ti shpëtojë ndëshkimit. Dhe ne, që të gjithë, disa prej neve janë të mirë e disa mëkatarë, gënjeshtarë e të dëgjueshëm do t'i dënojmë me zjarr. Kuptimi i vërtetë i këtij ajeti është ky. Duhet ta kuptojmë fjalën, „do të sillet”. Sjellja e ujit ka kuptimin ardhja e ujit prej vendit të tij ,e ai vend është burimi. Unë e kam sjell bagëtinë time te uji ata kanë pi , mirëpo unë nuk kam pi dhe jam kthye me ta, pra kush është me mua pi por unë nuk kam pi. Pra „sjellja te uji” do të thotë me i sjell te burimi i ujit ,ndërsa pirja apo mospirja është çështje tjetër.

„Dhe secili prej juve do të sillet në të. Allahu dëshiron të tregoj vlerën e tij te ta. Do të thotë: Ju që të gjithë do ta shihni zjarrin do të kaloni nëpër ta. Mirëpo ne e dimë se ajetet e Kur'anit e shpjegojnë njëra-tjetrën. Zoti i Lartmadhëruar thotë: „Dhe ai i cili tejkalon zjarrin dhe nuk bie në te ,por hyn në xhenet ai ka shpëtuar”

Pra secili prej nesh do ta sheh zjarrin ,ndërsa robërit e mirë orientohen në drejtim të qiellit dhe do të thonë: O Zoti im Falënderojmë Allahun i cili na shpëtoi prej përvëlimit të madh të cilin e pamë vetë, dhe na bëri ta tejkalojmë zjarrin ,dhe na shpëtoi prej tij. Begati e madhe për njeriun është që të mos hyjë në xhenet por të mbesë në (EARAF) mes xhenetit e xhehenemit, por begati shumë e madhe është për me tejkalar zjarrin dhe me hy në xhenet. Ky është fitim i pakrahasueshëm .Ju është shmangë dënimit të zjarrit dhe është siguruar prej tij. Në të njëjtën kohë kënaqet me të mirat e xhenetit. Kjo është rruga e imanit dhe rruga e cila shpie ne xhenet në të cilin ka të mira të cilat syri as që i ka pa ndonjëherë, veshi as që i ka dëgjuar ndonjëherë dhe as që ka menduar ndokush ndonjëherë për të mira të tilla.

O Zoti ynë ,na ofro rrugën e xhenetit Tënd, dhe na bënë që të hyjmë në te, na lehtëso të gjitha çështjet qofshin me fjalë dhe qofshin me punë që të hyjmë në te.

## SHPIRTI DHE MATERIA

E dimë se Islami bën paralelizim në mes të materies dhe shpirtit, mirëpo ka mendime se „Ka dallim të madh mes shpirtit dhe materies" dhe secili i takon botës së tij të veçantë. Si ti harmonizojmë këto dy mendime , kur po shihet se këto mendime jan kundërthënëse. Imami ynë i nderuar na sqaron ajo që për ne është e paqartë. Zoti e bekoftë.

Përgjigjja: Shpirti dhe materia , kjo është vetëm fjalë. Në esencë shpirti është i mirë, e keqja prej shpirtit vjen prej atëherë kur të depërton në materie dhe e përbën njeriun ,sepse atëherë njeriu(NEFSI-EPSHI) vepron ç'dëshiron.

Esenca e tërë ekzistencës është materie e të mirës pastërtisë dhe ibadetit. Për këtë arsye në atë moment kur dëshiron (epshi) e vendos materia,kthehet në natyrshmërinë e saj,,Atë dite kur do të dëshmojnë gjuhët e tyre ,duart e tyre dhe këmbët e tyre atë çka kanë punuar" (EN NURË24). Tani kompetencat kanë kaluar në Allahun ,më herët kompetenca mbi ta ka qenë komptetenca e dëshirës(epshit) mbi pjesët e trupit .Oj dorë bjeri filanit,oj dorë vepro këtë dhe këtë.Dora nuk ka mundësi me kundërshtuar, sepse dëshira jote e ka udhëheqjen mbi ta,ndërsa në ditën e kijametit ti nuk e ke atë mundësi,për këtë arsye edhe dëshmojnë kundër dëshirës tënde dhe kundër teje. Materia e pabesimtarit i bën tesbih Allahut ,ndërsa ajo reflekton dëshirën e pabesimtarit (shiko sa mahnitëse materia substanca lartëson Allahun ndërsa reflektimi i saj prej dëshirës së pabesimtarit është pabesimi. Mos thuaj o biri im shpirtëror material,kjo është fjalë sipërfaqësore nuk është shkencore ,sendet nga natyrshmëria e tyre bëjnë tesbih dhe adhurojnë ,për këtë arsye nuk cilësohet vetëm materia , po ashtu nuk cilësohet vetëm shpirti por bëhet fjala për NEFSIN-TRUPIN ME SHPIRT. Kuptimi i NEFSIT është shpirti me trupin pastaj vjen dëshira etj etj. Për këtë arsye vjen deri te mjegullinat, A u sqaruar çështja?

## VLERA E LEXIMIT TË KUR'ANIT

Zoti i Lartmadhëruar thotë:Dhe lexoni çka është më së lehti prej Kur'anit.

Po ashtu thotë:„Dhe ne e kemi lehtësuar Kur'anin për përkujtim por a ka ndonjë që logjikon

Po ashtu thotë: Dhe e kemi marrë përsipër ,e detyrë e jona është që ta tubojmë dhe ta lexojmë atë. Dhe atëherë kur ta lexojmë atë, përcjelle leximin e tij.

Leximi i Kur'anit është ibadet .Koha më e vlefshme e të lexuarit të Kur'anit është sabahu,ku Zoti i Lartmadhëruar thotë: “Dhe leximi i Kur'anit në sabah është dëshmuar" Pra e dëshmojnë edhe melaqet e natës dhe të ditës.

Pyetja është:

Cili lexim ka me shumë shpërblim leximi në heshtje apo leximi me zë?

Përgjigjja:Më së miri është të lexuarit me zë dhe përmendësh .

Po ashtu lexo edhe duke shikuar në Mus-haf ashtu që të ketë shpërblim shikimi yt dhe shpërblim dëgjimi yt( i veshit tënd)Po ashtu të ketë shpërblim gjuha jote . Kur'ani nuk është thjeshtë vetëm fjalë e cila theksohet ,por secila shkronjë është melaqe. Kur'ani ka dashuri,sikurse është dashuria njerëzore ,nëse e le anash e harron.

Pyetje: Ka njerëz të rëndomtë dhe të huaj të cilët e lexojnë Kur'anin dhe nuk i kuptojnë domethëniet e tij e as mrekullitë e tij. Ato a shpërblehen për leximin e Kur'anit?

Përgjigjja: Leximi i Kur'anit është dy llojesh; Lloji i parë është lexim adhurimi dhe ky lexim nuk ka të bëjë me kuptimin,sepse se sado që ta kuptojmë Kur'anin ajo është çka na ka mundësuar Allahu dhe sa kemi mundësi ne. Leximi i shprehjeve të Kur'anit të cilat

Allahu dëshiron që të na mundësoj të kuptojmë prej tij ndërsa nuk është ajo çka dimë dhe çka kuptojmë prej tij.

Ndërsa kur ta lexojmë Kur'anin për të nxjerr ligje prej tij kjo është krejt një çështje tjetër. Studiuesi e lexon Kur'anin dhe thotë: „prej këtij kuptimi nxirret kjo, prej kësaj fjale kjo.„, Dhe sikur të ktheheshim te i dërguari dhe te ata të cilët vet e kanë emëruar, do ta dinim se ata çka e kanë nxjerrë prej tij (prej vet mesit të tyre).

Pra unë e lexoj Kur'anin për të kuptuar qëllimin që dëshiron Allahu ta kuptoj prej tij.

Duhet ta dimë shfrytëzimi (dobia) në çështje nuk do të thotë të kuptuarit e mënyrës së shfrytëzimit (dobisë). Njeriu i rëndomtë përfiton prej ekranit televiziv, ose prej zërit të radios, mirëpo inxhinieri e di çdo çështje të saj në brendi. Mirëpo pse unë nuk i di pjesët e brendshme të atij mjeti nuk do të thotë se nuk mund të përfitoj prej tij. Nëse nuk e di përbërjen e barërave a do të thotë se unë nuk do të përfitoj asgjë prej atyre barërave?

Jo kurrsesi jo, se atëherë çdo pacient (i sëmurë) do të kërkonte prej farmacistit përbërjen e çdo hapi (bari) të cilën e merr prej tij.

Pra leximi i Kur'anit e kuptova apo nuk e kuptova më bën dobi.

Ne duhet ta kuptojmë Kur'anin aq sa kemi mundësi, e Allahu nuk na ngarkon më shumë se sa kemi mundësi.

## **ATA TË CILËT DO TË SHPËRBLEHEN ME TË MIRA EDHE MË SHUMË SE KJO**

Pyetja: Kanë thënë: “Edhe më shume se kjo” është të shikuarit në Allahun e Lartmadhëruar në xhenet. Allahu ka caktuar që ne besimtarët e devotshëm, që në xhenet ta shohim madhërinë e Tij. Allahu nuk e thyen premtimin.

Si do ta shohim Allahun në botën tjetër, me shqisat tona lëndore të kësaj bote? Apo ndoshta do të shndërrohen në shqisa tjera (superiore) për të pa dritën e te Gjithëfuqishmit

Përgjigjja: Imami i nderuar Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë: Po, në botën tjetër do ta shohim Allahun e Lartmadhëruar. Mirëpo vështirë e kemi ta parashikojmë këtë, nëse mendojmë se do ta shohim me shqisat tona tokësore, mirëpo Allahu i Lartmadhëruar do të shndërrojë shqisat rrënjësisht në shqisa tjera të cilat do të jenë harmonike me botën tjetër. Mirëpo Allahu na për afron. Allahu ka krijuar sende në tokë të cilat nuk mund të shihen për të na tregu për afërsisht për sendet e fshehta. Ka sende të cilat nuk mund të shihen me sy, mirëpo me zbulimin e mjeteve dhe aparateve i shohim. P.sh. mikrobin më parë nuk e kemi parë, mirëpo pse nuk e kemi parë nuk do të thotë se ai është i paparë, mirëpo syri yt nuk mund ta sheh e argument për këtë se unë po mund ta shoh me mikroskop. Sendi i cili nuk shihet ose mundet me qenë për shkak të largësisë (distancës) ose për shkak të imtësisë.

Mikroskopi e zmadhon të voglën, teleskopi e afron të largëtën. Shkak i asaj pse nuk i shohim apo nuk i kemi parë është mungesa e aparateve.

E ne kur të ringjallemi, ne do të kemi preparate tjera për ne me pa atë çka nuk kemi mund me pa më herët. Për këtë arsye në berzah në çastin e vdekjes hiqet perdja (pengesa) dhe ne mund të shohim atë që nuk kemi mundur me pa më herët (ne jetë). Pra secila (pjesë e jetës) i ka ligjet e saja. Ta marrim shembull jetën tonë, ajo kalon nëpër dy faza, në gjumë dhe zgjuar. Ligji i gjumit ndryshon prej ligjit të zgjuar në gjumë (në ëndërr) shohim njeriun e veshur me rroba të bardha në automjet të gjelbër. Po si i kam dalluar ngjyrat përderisa sytë i kemi pasur të mbyllur.

Pra, gjatë gjumit ne kemi mjet i cili i percepton (i sheh) gjërat pa i pasur sytë hapur.

Shoqërimi në gjumë nuk ndikon në ne. Dy persona flenë në të njëjtin shtrat , njëri sheh veten e tij të lumtur e tjetri sheh veten e tij të pikëlluar,ku njerëzit rreth e rrotull e rrahin dhe asnjëri nuk ndien përjetimin e (ëndrrës )së tjetrit.

### **DHE NE I KEMI NËNSHTRUAR ATA**

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe ua bëmë ato që t'u binden atyre, e disave prej tyre u hipin, ndërsa prej disave ushqehen”.

(*Jasinë, 72*)

Në ajetin e lartpërmendur çfarë qëllimi ka pjesa “dhe ne i kemi nënshtuar për ta”. Shpresojmë se Imami i nderuar do të na sqarojë .

Përgjigjja: Njeriu është mëkëmbës i Allahut në fytyrën e tokës,dhe ekzistenca të jen në shërbim të tij,,toka e nënshtuar për te ,kafshët e nënshtuara për te ,sendet e ngurta në shërbim të tij mirëpo njeriu është indiferent,ai mendon de të gjitha ai i ka nënshtuar. Për këtë arsye ai thotë njeriut jo,nuk i ke nënshtuar ti, por ne i kemi parapa për t'u nënshtuar ty, po mos ti kishte nënshtuar për ty ,ti nuk kishe pasur mundësi t'i nënshtosh.

Për këtë në gjithësi sheh gjëra mahnitëse ,sheh se si fëmija e sjell devenë e madhe nga të dojë ,ndërsa trimi i trimave nuk guxon ti afrohet gjarprit. Devenë e ka nënshtuar Allahu për ty,ndërsa *këtë nënshtim për ty ,që të thotë: nëse mundesh ta nënshtosh me fuqinë tënde nënshtroje!!*

ti nuk mundesh ta nënshtosh bubuzhelin (akrepin) i cili të trembë e të frikëson kur të biesh me fjetur , mirëpo ti mundesh ta nënshtosh elefantin. Interesant!! Pra çështja është se ti me fuqinë tënde dhe mundësin tënde nuk mund të nënshtosh. Mirëpo ai i cili të ka krijuar , për ty ato i ka nënshtuar. Po nëse diçka nuk ka nënshtuar për ty ti kurrë nuk mundesh ta nënshtosh.

### **NE KEMI ORIENTUAR RRUGËN**

Çfarë kuptimi ka ajeti,,Vërtet ne e kemi orientuar rrugën e kush prej jush le të falënderon ,e kush mohon?

Përgjigjja: Kur Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Ne e kemi orientuar rrugën ". Është shpjeguar rruga ,ose falënderues ose mohues. Vija është rrugën të cilën e ke marrë ti ose për të falënderuar, ose për ti mohu begatit e Allahut,ajo është për të dy veprimet. Ndoshta dikush mund të thotë:,,Dhe ne ia kemi udhëzuar dy rrugë"që do të thotë edhe për këtë rrugë edhe për atë,por çka është prioritare mes këtyre dy rrugëve ,pasi që bën për këtë,por edhe për atë çka e bën prioritare Allahu,për ta bë obligative për veten time atë rrugë. Po,po të kisha qenë i krijuar vetëm për një rrugë do të kisha thënë :Jo,Unë nuk kam mundësi të shkoj në rrugë tjetër ,pse e kam vetëm këtë rrugë. Mirëpo Ai Allahu është orientues në një rrugë ,ndërsa garuesi i ka dy çështje para vetes :Ose me qenë falënderues ose me qenë mohues.

Pyetje: Po cili mjet zgjedh mes këtyre dy gjërave?

Përgjigjja:Pa dyshim se ai mjet është ,pse kjo është detyra e tij,dhe ne e kemi udhëzuar atë

në dy rrugë. Pastaj Zoti i Lartmadhëruar thotë: Beto hem për diellin dhe shkëlqimin e tij. Për hënën kur e përcjell atë! Për ditën kur ndriçohet plotësisht .Për natën kur e fsheh atë(diellin)! Për tokën dhe për Atë i Cili e bëri shtrojë atë. Për shpirtin dhe për Atë i Cili e përsosi atë. Pastaj e orientoi atë dhe ia tregoi atij çfarë është e gabuar dhe çfarë është e drejtë për të! Vërtet ka shpëtuar ai i cili e ka pastruar atë(shpirtin e tij). Dhe ka dështuar ai i cili e ka prishë veten e tij.

ESH SHEMS 1-10

### **MES-HI MBI KOKË**

Mes-hi i një pjese të kokës a është mes i cili do vend të kokës ,sa që pranohet edhe nëse i ipet pjesës së prapme e jo pjesës së përparme?

-Në disa mendime lejohet mes-hi në pjesë të kokës dhe nuk është kushtëzuar me i dhën mes-h pjesës së përparme e as së prapme. Allahu e di më së miri

### **MREKULLIA E KRIJIMIT**

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Allahu është sunduesi i qiejve dhe tokës, Krijon çka të do , Kujt të do i jep(fëmijë) vajza dhe kujt të dojë i jep (fëmijë)djem,ose u jep (fëmijë) djem e vajza. E po ashtu cilin do e bën shterpë.

- Cila është urtësia e cila rezulton nga ky ajet. Dhe cili është garantuesi absolut .kam për qëllim garantues i çështjeve të cilat i tregon ky ajet?

Përgjigjja: Nëse e parashtrijmë një tavolinë në çështjen e krijimit të njeriut në Kur'an shohim se ne jemi të krijuar prej Ademit, Allahu prej tij ka krijuar bashkëshorten e tij. Ja shiko:bashkëshortja e tij a është krijuar prej tij apo prej llojit(prej elementeve) siq e ka krijuar atë. Pastaj shohim se njerëzit për nga krijimi jan të krijuar në katër mënyra. Njeri as prej nënës e as prej babës,njeri vetëm prej babës,njeri vetëm prej nënës (e nderuara Merjeme) dhe prej nënës e babës të gjithë njerëzit tjerë. Mirëpo ka babë dhe nënë(qift bashkëshortor) të cilët nuk kanë fëmijë. Pra nuk mund të thuhet absolutisht se patjetër çdo njeri duhet me qenë të krijuar vetëm prej nëne dhe prej babe. Zoti ka krijuar atë cili nuk ka as nënë e as babë, ka krijuar vetëm prej babës , dhe ka krijuar vetëm prej nënës. Por mundet me qenë edhe nëna edhe baba,por Allahu nuk ka dëshiruar që të kenë fëmijë ata dy, edhe pse ata i kanë të plotësuar të gjitha kushtet që të kenë fëmijë . Pra këtu është pika kulminante e fuqisë absolute te Allahu,kur të gjithë ligjet paralelizohen pran tij.

### **LEXIMI I KUR'ANIT PA E KUPTUAR**

Pyetje: nëse njeriu e lexon Kur'anin mirëpo nuk e kupton asgjë prej atij leximi a shpërblehet apo jo?

përgjigjja: Po shpërblehet ,sepse ai është lexim adhurimi.

### **FOTOGRAFIT ME KAFSHË NË SHTËPI**

Çka është puna me ata të cilët e zbukurojnë murin duke pikturuar gjallesa. A është njësoj sikurse të gdhendurit e statujave dhe a është haram?

I nderuari Shejh Sheaëraviju përgjigjet:

Nuk ka asgjë në këtë por ajo çka është haram është ajo që disa i madhërojnë dhe i

shenjtërojnë kafshët,ndërsa pikturimi vetëm për zbukurim nuk është kurrfarë pengese.

## **FJALA PËRFUNDIMTARE**

Mjaft kemi folur. Në hyrjen e këtij libri kemi folur mjaftë për ndjenjat e të vdekurve ndaj të gjallëve për atë se ata e ndiejnë atë që na ndodhë neve , çka sillet rreth neve në këtë botë kalimtare. Ata gëzohen kur ne jemi të lumtur ,dhe hidhërohen kur jemi të pikëlluar. E kjo çka është gjurmuar prej haditheve. Kemi paraqitë mendimet kundërthënëse ,argumentet dhe sendet. Na ka mundësu Allahu që çdo kundërargument t'i përgjigjemi me kundërargument. Këtu dëshirojmë ta dimë se çfarë mendimi ka i nderuari Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju në lidhje me këtë çështje.

Pra pyetja është:Të vdekurit a ndiejnë diçka për ne apo jo,dhe lutja jonë që tu falen mëkatet dhe të mëshirohen a arrin te ta apo jo?

Përgjigjja: Shejh Shaëraviju thotë: Po, i vdekuri ndien për të gjallët .Po mos të kishin ndie asgjë ,atëherë Ligjvënësi (i dërguari i Allahut s.a.v.s.) nuk do të na kishte urdhëruar që kur të shkojmë te ta me i përshëndet me „ESELAMU ALEJKUM DARU KAUMIN MUËMINIJE ENTUN SABIKUNE VE INNA SHAALLAHU LAHIKUN” Që DO Të THOTË: Paqja dhe shpëtimi qoftë mbi ju shtëpi e besimtarëve,ju na keni parapri ,por nëse do Allahu ne do të vijmë pas jush". Ligjvënësi na ka urdhëruar me i përshëndet ato ,e kjo do të thotë se ato patjetër përgjigjen.

Sa i përket lutjes,Pa çka është ajo e cila pengon që shpërblimi i lutjes dhe mëshira të arrijë te ato!!pse a mos mundesh me taku që një njeri e dënon një tjetër mirëpo në atë kohë shkon ndërmjetësues dhe ia ndërpret dënimin. Cili është qëllimi i kësaj. Qëllimi është që unë ta ndiej dhe ta kem parasysh se unë kam nevojë për mendimin e tjetrit për veten time,dhe mendimi i tjetrit mund të më shpëtoj dhe të më bëj dobi,ashtu mendimet e mira më bëjnë dobi për këtë arsye angazhohem të sillem mirë me njerëzit që të më donë edhe kur të vdes , sepse unë atëherë kam lënë bagazh të mirë te të gjithë njerëzit se ndoshta ndonjëri prej tyre do të lutet për mua. Pra kjo është që ti të punosh që te njerëzit të lësh vetëm çka është e mirë.

Nuk duhet që gjërat me i marrë të ndara. Allahu ka krijuar gjithësinë në asi sistemi që ta ndihmojmë njëri-tjetrin,e mos me ekzistuar armiqtësi. Unë kur ta shoh një cilësi të mirë të ndonjë person dëshiroj ta kem,po nëse nuk mund të bëjë punë të mira së paku mos ta nënçmojë dhe të mos tallem me punën e mirë. Sepse ajo punë e mirë e tjetrit do të më sjell dobi dhe të mira edhe mua. Qëllimi kryesor është që të lë punë të mira dhe përshtypje të mirë te të gjithë njerëzit.

## **AGJËRIMI I TËRË VITIT**

Pyetje:prej vegjëlisë më mjafton vetëm pak ushqim dhe nuk ma ka ëndja ushqimin. kjo është ajo që mund të agjëroj me lehtësi. A lejohet me agjëruar gjatë gjithë jetës. Dhe a është e vërtetuar prej të parëve tanë të mirë se ka agjëruar gjatë tërë jetës?

Përgjigjja: Është pyetur i Dërguari i Allahut s.a.v.s. :O i dërguar i Allahut si është puna me atë i cili e agjëron tërë vitin?

Ka thënë:Nuk ka agjërim dhe mosagjërim apo ka thënë,,as nuk ka agjëruar, as nuk ka ngrënë"ka thënë: Po me agjëruar dy ditë e me ngrënë një ditë.???/

Është përgjigja: Po a mundet dikush ashtu?

ka thënë: Si është puna me atë i cili agjëron një ditë e nuk agjëron dy ditë

Është përgjigjur: Do të kisha dashur po të kisha mundur ashtu

Pastaj i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: Tri ditë çdo muaj, dhe prej ramazanit në ramazan ,kjo është sikurse me agjëruar tërë vitin. Nëse agjërohet dita e arafatit bëhet falja e gabimeve të vitit të kaluar dhe vitit paraprak ,agjërimi i ditës,,ASHURA" i fshin mëkatet e viti paraprak.

E KA REXHISTRU

AHMEDI

### **RUBIKONI I KURBANIT**

Cili është sekreti i imanit në therjen e kurbanit?

Zejd ibn Erkami e ka pyetur të dërguarin e Allahut s.a.v.s : Çka është kurbanit?

Është përgjigjur: Sunet ,vepër e babës juaj Ibrahimit salallahu alejhi ve selem.

E ka pyetur pastaj: Po çfarë shpërblimi kam prej tij?

Është përgjigjur: Për çdo qime është një e mirë

E kanë pyetur: O i dërguari i Allahut ,a qime të leshit ?

Është përgjigjur: Për çdo qime të leshit është një e mire

TRANSMETON IMAM AHMEDI

### **EDHE NËSE ËSHTË E PAKTË**

Kur Muhamedi s.a.v.s. ka thënë : Kush i a merr të drejtën e besimtarit me përбетim të rrejshëm atij Allahu ia ndalon xhenetin dhe e shpie në zjarr

E kanë pyetur: Qoftë edhe diçka e imët dhe e lehtë?

Ka thënë : Qoftë edhe një krënde misvaku.

### **NJË SHKURORËZIM**

Një njeri e ka shkurorëzuar gruan e tij tri herë me një fjalë në një vend në prezencën e dëshmitarëve .A konsiderohet një shkurorëzim apo tre shkurorëzime?

Përgjigja: Ne edhe më herët jemi përgjigjur se konsiderohet një shkurorëzim, pse kur është pyetur i dërguari i Allahut s.a.v.s. për burrin i cili e ka shkurorëzuar gruan e tij tri herë përnjëherë është ngritur i hidhëruar dhe pastaj ka thënë: A edhe duke qenë në mesin tuaj po luan ai me Allahun? Deri sa një njeri është ngritur dhe ka thënë : O i dërguari i Allahut : A ta dënojmë me vdekje?

### **CILA ËSHTË E DREJTA E SECILIT PREJ KËTYRE**

Pyetje: Nëse vdes baba duke lënë pas vetes vajzën e djalit ,vajzës dhe motrën .Si ndahet trashëgimia në mes tyre?

Përgjigja: Është pyetur Ebu Musa el Eshariju për vajzën ,vajzën e djalit dhe motrën. Është përgjigjur: Vajzës i takon një e dyta dhe motrës një e dyta tjetër dhe ja po vjen Ibn Mes'udi dhe ai do të pajtohet me mendimin tim. Është pyetur Ibn Mes'udi dhe i kanë tregu se si është përgjigjur Ebu Musa e ai ka thënë: Ka lajthitur, dhe po të pajtohesha edhe unë do të isha në humbje . Gjyko ashtu siç ka gjykuar pejgamberi s.a.v.s vajzës një e dyta ,vajzës së djalit një e gjashta për tu plotësuar dy të tretat dhe çka mbet motrës.

BUHARIU

### **A PËRGJIGJET SHPYRTI NË VARR**

Kur të pyetet njeriu në varr i kthehet shpirti me fjalë tjera si do të bëhet gjykimi në varr?

Përgjigjja: E ka regjistruar Ahmedi se nga peygamberi s.a.v.s. se këtë pyetje ia ka parashtruar Omeri r.a. peygamberit s.a.v.s. „Në momentin e gjyqimit në varr a na kthehet mendja

Është përgjigjur: Po ashtu si e kemi (shpirtin dhe mendjen) sot.

### **ENA E TIGANISUR NË TË CILËN ËSHTË TIGANU MISHI I DERRIT**

Një profesor i universitetit thotë: se gjatë shkuarjes me një delegacion në Evropë , ku ka banuar në një shtëpi ,në të cilën e kanë përdor mishin e derrit,dhe e kanë pi alkool mirëpo enët dhe gotat pastaj i pastronin. Pyetja është: A e kam të lejuar ,apo të ndaluar ti përdori enë dhe të njëjta gota?

Përgjigjja: Ebu Thealebete el Hushmiju r.a. e ka pyetur peygamberin s.a.v.s: O i dërguari i Allahut : ne jetojmë në vend të pasuesve të librit e ato hanë mish derri dhe pinë alkool. Si të veprojmë me enët e tyre,ti përdorim apo jo?

Muhamedi s.a.v.s i thotë: Nëse nuk gjeni enë tjera pos tyre atëherë enët e tyre i pastroni , i tiganoni, po ashtu edhe gotat pastroni dhe pini në ta.

Pastaj tregon I kam thënë :O i dërguar i Allahut:po çka na lejohet dhe çka na ndalohet?Është përgjigjur: Mos hani mishin e gomarit ,dhe ju është e ndaluar çdo kafshë shqyese (me kthetra) mishngrënëse.

Në hadithin Sahihë të Muslimit nga ebu Hurejrete r.a. është vërtetuar se Muhamedi s.a.v.s ka thënë:Mishi i çdo kafshe mishngrënëse shqyese me kthetra është e ndaluar.

### **UTHULLA PREJ ALKOOLI**

Disa njerëz e alkoolin e shndërrojnë dhe e përdorin në uthull. Si është puna me ta. A është e ndaluar apo jo, duke pasur parasysh se qëllimi është i mirë.

Përgjigjja: Është pyetur i dërguari i Allahut për shndërrimin e alkoolit në uthull. E ai është përgjigjur: Jo nuk lejohet.

#### **E KA REXHISTRU MUSLIMI**

Disa njerëz e kanë pyetur të dërguarin e Allahut s.a.v.s Ne e shtrydhim lëngun e shtrydhur të fermentizuar e përdorim për drekë e darkë për pije (në një transmetim tjetër për ushqim). E Muhamedi s.a.v.s. u ka thënë : Pini , por largohuni nga çdo lëng dehës".

Pastaj ia kanë përsërit pyetjen e prapë Muhamedi s.a.v.s. u ka thënë: „Allahu u ka ndalu edhe të paktën , nëse e shumta e saj dehë"

E KA REXHISTRU DARUKUTNIJU

### **FALLTORET**

Çka thua për njerëzit e thjeshtë dhe injorant të cilët shkojnë për shërim apo për të ditur të fshehtë (fatin e tyre) të falltarët e të dexhallët  
„Për shkuarjen ke falltarët, Muhamedi s.a.v.s. ka thënë: Kurrë mos shkoni te ta. Është pyetur i dërguari i Allahut s.a.v.s për falltarët e ai është përgjigjur: Nuk ka asgjë prej tij. Njeri i cili ishte prezent i thotë: Po ata ndonjëherë po ia qëllojnë dhe po e dinë, e Muhamedi s.a.v.s i thotë: Ajo është e vërtetë të cilën Xhini Karijn ia tregon falltarit e pastaj ia përzien njëqind rrena tjera

MUTEFIKUN ALEJHI

### **SHARJA E PRINDËRVE**

Dëgjojmë për sharjen e prindërve prej djemve të tyre. Çka nënkuptohet me këtë dhe mosrespektimi i prindërve a është mëkat i madh?

Përgjigjja: I nderuari ynë, i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka thënë: „Prej mëkateve të mëdha është kur njeriu i shanë prindërit e vet.

Është pyetur: Po si e shan njeriu prindërit e vet?

Është përgjigjur: E shanë babën dhe nënën e tjetrit, e ai ia kthen duke ia sharë babën e nënën e këtij

MUTEFIKUN ALEJHI

Transmetohet nga Imam Ahmedi se Muhamde i s.a.v.s ka thënë: Prej mëkateve më të mëdha është mosrespektimi i prindërve.

Është pyetur: Po çka është (si bëhet, si shkaktohet) mosrespektimi i prindërve?

Është përgjigjur: Njeriu shan nënën e babën e tjetrit e ai ia shan babën e nënën këtij

### **NDËRPRERJA E LIDHJEVE FAREFISNORE**

Kam farefis të cilët nuk i përmbahen besatimeve e premtimeve, ato nuk i lidhin marrëdhëniet farefisnore janë kriminel, i ndërprejnë me mua të gjitha lidhjet, u bëjnë mirë ata ma kthejnë me të keqe, a duhet ti përforcoj lidhjet?

Përgjigjja: Një njeri e ka pyetur të Dërguarin e Allahut s.a.v.s., u bëjnë mirë ma kthejnë me të keq, sillem me butësi e ata më injorojnë. E Muhamedi s.a.v.s. i ka thënë: Nëse është e vërtetë ajo që thua ti je duke iu hedhur zjarr të nxehtë, dhe deri sa të vazhdosh ashtu Allahu do të ndihmojë. I dërguari i Allahut s.a.v.s ka thënë: Jo nëse të gjithë janë ashtu, por shiko më të vlefshmit dhe me ta përforcoji marrëdhëniet, sepse derisa të jesh në atë pozitë Allahu do të jetë me ty dhe do të ndihmojë.

### **ISRAJA DHE MIËRAXHI**

Pyetje: Pse Israja është tregu me tekst të qartë ndërsa Miraxhi me argument jo të drejtpërdrejtë?

Përgjigjja: Shejh Shaëraviu përgjigjet: Kur Kur'ani e ka tregu ngjarjen e Miraxhit e ka tregu qartë, mirëpo Miraxhin nuk e ka tregu ashtu, sepse nuk ka thënë: Lavdërimi i qoftë Allahut i cili e ka ngritur atë prej mesxhidi Aksas e deri në Siretul Munteha psh.

Mirëpo na ka tregu gjëra për ngritjen e nuk ka treg ne suretul Isra me argument të qartë për Sidretul Munteha.

Pastaj Shejh Shaëraviju vazhdon e thotë: Kjo është mëshirë e Allahut për krijesat e tij. Për çështjet praktike të cilat ka mund i dërguari i Allahut s.a.v.s. ti tregoj banorëve të tokës ,i ka tregu me argument të qartë ,që të mos ketë vështirësi gjatë transmetimit .Mirëpo në çështjet që mendja kërkon analizë më të thellë e ka lënë në bazë të Imanit tënd të fortë , apo varësisht prej parapërgatitjes tënde prej rezultateve tjera.

Të gjitha mrekullitë me të cilat i ka stolisë Allahu pejgamberët tjerë të gjitha kanë qenë jashtë ligjeve të zakonshme ,e pse mrekulli të tillë mos të ketë edhe i dërguari i Allahut s.a.v.s. Pasi që Allahu është Ai i cili vendosë e ndryshon ato ligje atëherë ai që beson ngjarjen e të dërguarit të Allahut s.a.v.s se për një kohë të shkurtë të natës është bartë prej Mekes në Mesxhidi Aksa ,e që kjo mrekulli praktike atëherë ai duhet të besoj për Miraxhin e cila nuk është mrekulli praktike. Sepse ai i cili të beson ty pasi që të njeh se je besnik ai të beson edhe për gjërat tjera që ai nuk i di.

Pyetje:Cili është dallimi në mes të atij i cili nuk e beson ngjarjen e Isras dhe atij i cili beson ngjarjen e Miraxhit?

Përgjigjja: Ai i cili e mohon Isranë është pabesimtarë ,sepse ai bie ndesh me argument të qartë. Ndërsa ai i cili e mohon Miraxhin , nuk është pabesimtar ,mirëpo ai është mëkatar i madh. Sepse Israja është tregu me argument të qartë ,ndërsa Miraxhi më argument që kërkon të besohet.

Pyetje:Cila është ndërlidhja mes Isras i cili është udhëtim tokësor -horizontal,ndërsa Miraxhi i cili është udhëtim qiellor-vertikal?

Përgjigjja: Pasi që Allahu i Lartmadhëruar për Muhamedin s.a.v.s e ka thyer ligjin kohor në Isra i cili është ngjarje tokësore i ka dhënë të dërguarit tonë pejgamberit s.a.v.s argumente praktike (lëndorë),pra që besimi ynë të jetë në suazat e gjërave tona të cilat i dimë ,e atë mrekulli pastaj e bënë mjet për të besuar dhe vërtetues se Ai i cili e ka thyer ligjin kohor me gjatësi tokësore në çështje të cilat i dimë ka mundësi të thyej ligjin vertikal(ngritjen në qiell) në çështje të cilat nuk dimë. Pra mund të themi se Israja është parapërgatitje e logjikës njerëzore për ta besu dhe për ta vërtetuar lajmin e Miraxhit të pejgamberit s.a.v.s

Pyetje:Cili është argumenti se Israja ka qenë edhe me trupë edhe me shpirtë?

Përgjigjja: Argument është fjala e Zotit të Lartmadhëruar .I lavdëruar është Ai i cili e ka bartur robin e tij për një kohë shumë të shkurtë të natës .Pse fjala,„robin e tij" nënkupton njeriun edhe me trup edhe me shpirt ,pra që të dyja në të njëjtën kohë. Dhe tjetra është se po të kishte qenë Israja dhe Miraxhi vetëm me shpirt apo të kishte qenë vetëm ëndërr nuk kishte pasur nevojë me kontestuar askush , a është e vërtetë apo dispozitë. Dhe pabesimtarët Kurejsh s'kanë pas nevojë me marr qëndrim negativ ,e të pyesin „Ti po thua se ke kaluar distancë për një kohë shumë të shkurtë të natës,ndërsa ne atë distancë e kalojmë për një muaj .Mirëpo vetë pyetja e tyre konfirmon se ata e kanë kuptuar se nuk ka qenë në pyetje as ëndërr e as udhëtim i vetëm me shpirt por ka qenë zgjuar edhe me trup edhe me shpirt. po të kishte qenë e kundërta nuk ka pasë nevojë për kundërshtim ,sepse ligji i ëndrës është superior ndaj ligjit zgjuesisë.

Pyetje:Cili është dallimi mes „ëndrës" dhe të „pamurit"?

përgjigjja: Fjala „ëndërr kam pa" vjen *infitiv* vetëm kur të jetë ëndërr iluzioni „kam pa ëndërr"sepse sa i përket shikimit me sy thuhet,„duke shikuar kam pa".Ndërsa nëse e shikon në gjumë thua „kam parë ëndërr"

Në poemën e rij Rai Nemiri thotë:

„Ëndërr shikon gjërat e mëdha që të habitet mendja.

Përgëzoje veten e cila më parë ka qenë e përgënjeshtuar.

Fjalën „shikim duke pa" e ka përdorur shikimin me sy dhe shikimin në gjumë. Mirëpo

zakonisht „shikimi në ëndërr” e përdorin për shikimin e gjërave mahnitëse të cilat nuk mund të shihen në ëndërr.

Pyetje :Zoti i Lartmadhëruar thotë,,

## **ISRA DHE MIËRAXHI**

Si të jetë ëndrra fitne për njerëzit .A është ky argument se israja ka qenë ëndërr?

Përgjigjja: Kjo patjetër duhet të interpretohet si shikim praktik. Pra nuk është kurrfarë pengese, që i dërguari i Allahut s.a.v.s. ta ketë pa ISRANË (udhëtim natën) në ëndërr e pastaj ta kishte bërë atë udhëtim zgjuar në praktikë (realitet) ashtu siç e tregon Zoti i Lartmadhëruar në disa sure tjera.

Zoti i Lartmadhëruar ,të dërguarit të tij ëndrën ia ka bërë realitet dhe ju me siguri do të hyni në Meshidul Haram .Pra e ka pa në ëndërr , e pastaj ëndrra iu është bërë realitet. Çfarë pengese ka këtu ,nëse Zoti i Lartmadhëruar ia ka vulosur në shpirt ,që ai në rend të parë të shohë në ëndërr ato ngjarje e ato ngjarje pastaj janë bërë realitet ,siç është hyrja në Mesxhid Haram ,shkurtimi i flokëve dhe qethja e shokëve në haxh e pastaj të gjitha i ka pa zgjuar. Pra kurrfarë pengese nuk ka që i dërguari i Allahut s.a.v.s. në rend të parë Isranë e ka pa ëndërr e pastaj ajo ëndërr të cilën e ka parë me shpirt , është bërë realitet.

Pyetje: A ka ardhur në „ETHER” se i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka pa ëndrra e pastaj janë bërë realitet?

Përgjigjja: Po, Ajsha r.a. thotë: „Çdo ëndërr që e ka pa i dërguari i Allahut s.a.v.s. të nesërmen në mëngjes iu është bërë realitet,sikurse qartësia e sabahut pas natës .Pra nëse ka pa ëndërr ajo është realitet.

Pyetje Zoti i Lartmadhëruar ka thënë

Pse në fund të ajetit nuk është,,Allahu ka mundësi për çdo send”

Përgjigjja: Këtu shkak është i qartë se e ka bërë që „ISRAJA” të dërguarit të Allahut s.a.v.s për shkak se pabesimtarët e kanë ofenduar të dërguarin e Allahut s.a.v.s. .E ato ofendime i ka dëgjuar po ashtu ka pa çka i ka ndodh Muhamedit s.a.v.s. lodhja ,mundimet si e kanë nënçmuar. Të gjitha këto Allahu edhe i ka pa edhe i ka dëgjuar. E kur Allahu i ka pa e i ka dëgjuar atëherë ka dashur që Muhamedi s.a.v.s. t’ia mundësojë të sheh ajetet e mëdha dhe ia ka mundësuar ISRANË.

## **SHAËRAVIJU DHE LËMIA MEKANIKE**

Për ngjarjen e ISRAS Shejh Shaëraviju thotë:Sa më shumë që të shtohet shpejtësia (forca) zvogëlohet distanca. Pra distanca dhe shpejtësia janë refleksive , varësisht prej njëra tjetrës.

Forca (shpejtësia) e cila ka qenë forca (shpejtësia)e Allahut e cila nuk ka kohë. Këtu Shejh Shaëraviju na paraqet ligjin(parimin) e rëndësishëm të mekanikës i cili thotë: Distanca është e barabartë me shpejtësinë e kohën.

Pasi që distanca është e palëvizshme ,atëherë sa më shumë që të rritet shpejtësia aq më shumë zvogëlohet koha për atë distancë .Kështu që koha për Allahun është e barabartë me zero Subhanallah

## **LOGJIKA (METODOLOGJIA) E THIRRJES NË BESIM**

Pyetje:Cila është logjika e thirrjes në Islam. Çfarë dialogu parasheh Islami. Cila është zemërgjerësia fetare ,dhe mostoleranca fetare. Dhe çka është ajo e cila e bënë që të gjithë të jetojnë nën një hije ,pra edhe fetë tjera?

Përgjigjja: Shejh Muhamed Muteveli Shaëraviju thotë:Islami ka metodologji të mirë edukative dhe madhështore . Logjika e besimit është mëshira, fortësia e tij,është Imani i cili manifestohet në atë se drejtësia është parim dhe nuk ka mbizotërim të njeriut ndaj njeriut ,mirëpo thirrja në besim në te duhet të bëhet me edukatën e të dërguarit të Allahut s.a.v.s varësisht në aftësinë e të kuptuarit dhe rrethanave në të cilat gjendet ai i cili thërret në besim.

Thirrësi Islam nuk duhet që njerëzit në vend se t'i thërrasë, t'i largojë ashtu siq e kanë bërë zakon me metodologji të urrejtjes ndaj të tjerëve,sepse njeriu thirret në udhëzim. Dihet se thirrja me gjuhën e urrejtjes u shkakton njerëzve dy vështirësi.

Vështërsia e parë :Largimi i njerëzve edhe më shumë ,dhe dëbimi sa më larg në atë çka e kanë traditë.

Vështirësia e dytë: Mbylljen e rrugës , e cila i shpie ata në diçka të re ,edukata e keqe ,dhe mos këshillimi me urtësi,e cila ndoshta në ndonjë moment ishin drejtuar në rrugë të vërtetë .Për këtë arsye një beduin në të kaluarën ka thënë: Këshilla është aq e rëndë , sa që nuk mund ta bartë as mali (kodra) e mos ia dërgo kodrën me bart se e vështirëson polemikën edhe më shumë, por merre këshillën më sqarim të lehtë.

Nëse e parashtrijmë pyetjen: Pse këshilla është aq e rëndë ?

Përgjigjja është sepse këshilla të këshilluarin e nxjerr prej asaj që ai e ka dashur shumë më herët. Pra kjo është se këshilla është e rëndë.

I këshilluari dëshiron që t'i zbukurosh çështjet që ia ka ënda ,dhe ia do epshi ,e i këshilluari nuk dëshiron të mendoj për përmirësimin e gjendjes së tij. Për këtë arsye e shohim ilustrimin madhështor të cilin e përdor Kur'ani,kur i dërguari i edukuar me edukatën e Zotit të tij u thotë kundërshtarëve të tij:„Thuaj:Ju nuk do të pyeteni për krimet e tona ,e ne nuk do të pyetemi për punët tuaja"

Muhamedi s.a.v.s. u thotë kundërshtarëve të tij se çdo njeri përgjigjet për veprën e tij. E ju besimtarë ,pra e ka quajtur krimin për veten e tij dhe për besimtarët,sepse kundërshtarët në fillim imanin e kanë quajtur krim

Mirëpo i dërguari i Allahut s.a.v.s sjelljen e kundërshtarëve nuk e ka quajtur ashtu,por me fjalë të Allahut u ka thënë:Ne nuk përgjigjemi për veprat tuaja.

Nëse bëjmë një analizë i dërguari i Allahut s.a.v.s. ka qenë dashur të thotë: Dhe ne nuk pyetemi për krimet tuaja, mirëpo e ka thënë të kundërtën „çka punoni".Pra Allahu ia ka mësuar të dërguarit të tij metodën e dialogut dhe diskutimit.

Kjo është edukata e dialogut ,kjo është pasqyra e diskutimit ,por duhet të dimë se epshin njerëzor duhet ta ngrisim lartë dhe të diskutojmë më logjikën e së vërtetës qiellore në qiell.

Kështu duhet të jetë i përgatitur thirrësi islam?

Kështu duhet të presim të gjithë kundërshtarët e islamit ,duhet patjetër që kundërshtarët e kësaj feje të shijojnë dhe të jetojnë në mëshirën e kësaj feje.

Pyetje:Nëse kundërshtarët e shfrytëzojnë dhe e keqpërdorin tolerancën e ngriten kundër tij për ta sunduar,si duhet vepruar?

Përgjigjja: Nëse ata mendojnë dhe veprojnë ashtu,atëherë Islami kërkon prej besimtarëve të mbrohen me çdo kusht kundër tyre që nga fillimi e deri sa fjala e Allahut të jetë më e larta. Sepse është e qartë se nëse në një vend të drejtët sulmohen prej të këqijve dhe kriminelëve Allahu i ka mësuar njerëzimit si duhet vepruar.

Pyetje:Si do të kishte qenë jeta nëse e keqja dhe e padrejta mbizotëron dhe udhëheq?

Përgjigjja: Nuk ka dyshim se jeta do të jetë e keqe ,nëse atë e udhëheq e keqja,sundimi i ligjit dhe drejtësisë është sundim i programit të Allahut.

Ne e mësojmë dhe e kuptojmë të drejtën prej të padrejtës atëherë kur bëhet krahasimi mes tyre ,e Allahu na ka mësuar që këtë ta bëjmë me gjuhën e dialogut.

Allahu na ka mësuar se e vërteta arrihet me fuqinë e së drejtës dhe argumenteve. Askush nuk i bën padrejtësi askujt me logjikën e drejtësisë dhe vërtetës.

Pyetje: Si ka udhëheq Islami dhe si e ka largu të keqen?

Përgjigjja:Nëse e shikojmë historinë Islame,do të shohim se Islami është zhvilluar në dy qstje:

E para: Të nxiturit e besimtarëve në përhapjen e kësaj feje,e cila i udhëzon njerëzit,e në këtë kanë pasur vullnet dhe kjo ka qenë forca e tyre.

E dyta:Kërkesa e qytetarëve apo banorëve të sunduar prej kriminelëve të cilët kan kërku sundimtarë të drejtë tu ndihmojnë. Kështu ne e shohim se të gjitha çlirimet e vendeve islame është bë në bazë të thirrjes së atyre vendeve të çliruara,ashtu që banorët e atyre vendeve kanë kërkuara që muslimanët të shkojnë te ata dhe ti nxjerrin nga e keqja dhe torturimi që u bëhej atyre.

Për këtë arsye ne shohim shumicën e popujve të cilët e kanë pranuar islamin nuk e kanë pranuar për shkak të dhunës apo me forcë ose me lufte,dhe si rezultat i kësaj del se shumicën e pjesëtarëve të vendeve të cilat i kanë çliruar muslimanët ka pasur edhe pjesëtar të feve tjera.

Zoti i Lartmadhëruar thotë:Dhe thuaj: E vërteta është nga Zoti i juaj e kush do le të besoj ,e kush do le të mohoj. Ne kemi përgatitur zjarr për mohuesit keqbërës ,që do ti përfshij nga të gjithë anët .nëse do të kërkojnë ndihmë,do tu jepet një ujë si xehja e shkrirë që do tua përcëlloj fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo,sa strehim i keq është ai(zjarri)!

### **ISLAMI EMËR ,CILËSI DHE SIMBOL**

Pyetje: Cili është dallimi të fjala Islam si emër , cilësi dhe simbol dhe a është e vërtetë se secila ka kuptim në vete?

Përgjigjja: Nëse shohim fjalën Islam e shohim se është përdorë në kuptim të emrit , cilësisë dhe simbolit.

Sendi kur të jet cilësi e ka kuptimin e cilësimit.

Mirëpo sendi kur të jetë i emëruar atëherë merr kuptim edhe më të gjerë. P.sh. nëse ndonjëri prej neve thotë:„A e ke parë hënëën?"Dëgjuesit menjëherë i shkon mendja të planeti hënë i cili shndritë dhe ndriçon tokën gjatë natës pasi ta merr dritën prej diellit.

Mirëpo nëse ndonjëri nga ne e quan vajzën e vet,„hëna"a do të thotë se cilësitë e hënës gjenden të kjo vajzë?!

Jo, sepse ajo mund të mos jetë e bukur por prapë se prapë baba i vet e quan „hënë"

Saktësisht ,sikurse një njeri është fatkeq ,dhe i keq përkundër asaj se prindi i tij e ka emëruar me emrin e mire fatlum.

Mirëpo fjala,„ISLAM" është emër,cilësi dhe simbol në të njëjtën peshë. Po pse? Sepse njeriu nuk mundet të jet i sigurt apo i qet prej atij i cili është më i fuqishëm se ai,as prej atij i cili është i barabartë. Ku është dallimi mes cilësisë dhe gjendjes (ndajfoljes së gjendjes).Cilësia është e pandryshuar ndërsa gjendja e ndryshueshme .Fjalja pas trajtës së shquar është ndajfolje e gjendjes ,ndërsa pas trajtës së pashquar është cilësi.

P.sh ka dallim të madh në mes të thënies „është bë i tij i djegur plotësisht". Fjalja e parë,„i djegur plotësisht" është fjali emërore,në rasën emërore dhe gjendja e automjetit është ndryshuar. Ndërsa fjalja e dytë: „është i djegur" është fjali emërore në rasën

emërore,cilësi,e cilësia është e pandryshuar,ndërsa ndajfolja e gjendjes e ndryshuar.

### **FUQIA E TË DOBËTËVE NË DASHURI**

Pyetje:Ku është fuqia e dashurisë së të dobëtëve ,cili është rezultati i kësaj dashurie në fitoren e Islamit dhe ngritjen e flamurit të Tij?

Përgjigjja: Nëse e dimë se çfarë vështirësi ka përjetuar i dërguari i Allahut s.a.v.s. në fillim të jetës së tij, nuk ka pasur mundësi të mbroj shokët e tij.

Ndoshta ky ka qenë simboli se Allahu ka dëshiruar që atij ti bashkëngjiten vetëm ata që kanë fuqinë e dashurisë. Këtë fuqi të dashurisë të cilën e kanë poseduar të dobëtët,ka qenë fuqi e pathyeshme para Kurejshitëve të cilët nuk kanë pasur mundësi ta ngrejnë kryet lartë. Kjo është fuqia e dashurisë së të dobëtëve e cila fuqi nuk mposhtet kurrë,edhe pse Kurejshitët e kanë pasur në dorë tregtinë dhe ekonomin,e udhëtimin e tyre dimër e verë.

Allahu i Lartmadhëruar ka dëshiruar që të dërguarin e tij ta ushtroj dhe ta sprovtoj për këtë arsye në fillim të shpalljes nuk ka fituar kundër kurejshitëve,pse po të kishte fituar që në fillim njerëzit do të thoshin: Kurejshitët janë fisi i tij,ata gjithmonë kanë qenë në pushtet,e e kanë bërë një lidhë të tyrin,që ta udhëheqin botën. Po të kishte ndodhë kjo , atëherë islami i cili ka arrit tek ne do të kishte qenë një fe e njoftësive,dhe do të ishte përhapur më njoftësi të fisit të Muhamedit s.a.v.s. .mirëpo Allahu ka dashur që kurejshitët të jenë kundër Muhamedit s.a.v.s dhe që nga lindja ,Muhamedi s.a.v.s të jetë i dobët,i dobët në mesin e qendrës së zhvillimit ekonomik,mirëpo i fuqishëm më Iman dhe bindje për të arritur qëllimin.

Kështu ëmbëlsira e Imanit e cila ka ardhur prej Muhamedit s.a.v.s është bërë njoftësia dhe familja e Muhamedit s.a.v.s.

Po të kishte dashur Allahu që Muhamedi s.a.v.s ta kishte forcën e mbizotërimit dhe sundimit nuk do të kishte pasur forcë për ta penguar,mirëpo Allahu ka dashur që robi i Tij t'i nënshtrohet me vullnet dhe dëshirë edhe atëherë kur ka mundësi të refuzoj.

Allahu dëshiron imanin e pa imponuar dhe të vullnetshëm dhe që robi i Tij ta pranojë me zemër ,ti përulet dhe ti nënshtrohet Allahut dhe ti përmbahet planprogramit të Tij edhe atëherë kur ka mundësi të mos besoj.

### **CILËSITË E HYRIVE TË XHENETIT**

Pyetje: Cilat janë tiparet e hyrive të xhenetit?

Përgjigjja: Hyri: e bardh, symëdha , flokëshndërritëse sikurse krahët e petritit.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti të ngjashëm me margaritarët e ruajtur ?

Përgjigjja: Shkëlqimi si shkëlqim i mëndafshit të cilin nuk e ka prekur dorë e njeriut.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti : Në ta ka shumë të mira të shumta?

Përgjigjja: Pamje të bukur dhe edukatë të mirë.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti: Sikurse me pas qenë vezë të ruajtura .

Përgjigjja: Butësia e tyre është si butësia e nënlëvozhgës së vezës.

Pyetje: Çfarë kuptimi ka ajeti : Të dashura (për bashkëshorte të tyre)?

Përgjigjja: Janë ata të cilat në këtë botë kanë vdekur në moshë të vjetër , mirëpo Allahu pas pleqërisë së tyre i ka shndërruar në virgjëresha ,uruben do të thotë: simpatike dhe të dashura , ndërsa etraba- do të thotë : të gjitha janë të një moshe.

### **KUR'ANI BARË DHE SHËRIM I SHOQËRIVE**

Pyetje: Zoti i Lartmadhëruar thotë:Dhe shëron zemrat e popullit besimtarë. Po ashtu Zoti i Lartmadhëruar thotë:Dhe ne zbresim nga Kur'ani atë çka është barë,shërim dhe mëshirë për besimtarët.

E pyesim Imamin e nderuar:Si i ka mënjanu dhe si i ka shëruar Kur'ani sëmundjet njerëzore ,dhe shkatërrimin e shoqërive nëpërmjet të programit të tij të drejtë të fortë dhe stabil.

Përgjigjja:Imami i nderuar thotë:ti shumicën e rasteve e kundërshton programin e Allahut sepse ai të përkufizon lirinë e aktivitetit në jetë ,për të cilën ti me mendjen tënde mendon se po t'kishe vepruar sipas epshit tënd do të zbaviteshe e tërë bota do të shkatërrohej. programi Islam është i shpallur prej Zotit të Lartmadhëruar . Ai është Allahu i cili e ruan Kur'anin mrekulli të njerëzimit. E programi i tij mrekulli e njerëzimit është se njeriu nuk ka dorë e kompetencë mbi të. Ai është fjalë e Allahut, e mbrojtur dhe e siguruar prej Allahut deri në ditën e Kijametit. Mrekullia në të qëndron se i jep njohuri çdo gjenerate edhe çdo gjenerate ndryshon prej gjeneratës së mëparshme. Mrekullia në të qëndron se është i përshtatshëm dhe harmonik për çdo kohë ,për çdo vend. Mrekulli në të qëndron edhe në atë se shëron sëmundjet e shoqërive kudo qofshin ,sepse është fjala e Allahut,e cila në vete përmban barin(ilaçin)për çdo sëmundje .E kjo do të thotë se vetëm të folurit e kësaj fjale( të Allahut) na sqaron se është mrekulli madhështore e Kur'anit fisnik.

Shpalljet kanë zbrit për të shëruar sëmundjet e shoqërisë dhe çdo shpallje e cila ka zbritur te një popull ka zbrit për ti shëruar sëmundjet apo për ti mënjanu degjenerimet të cilat ndodhin në atë shoqëri.

### **HARRESA SËMUNDJE E NJERIUT**

Pyetje:Në faza të ndryshme të jetës një prej fatkeqësive të njeriut është harresa .Pse është harresa fatkeqësi e krijesave dhe sëmundje e cila përcillet gjenerate pas gjenerate dhe a përgjigjet njeriu për shkak të harresës së tij?

Përgjigjja:Harresa është sëmundje e pashërueshme (e pashmangshme) e njeriut dhe ndryshimi i programit ekziston prej kohërave të lashta. Sepse njeriu largohet prej shumë çështjeve të programit të Allahut për shkak të harresës. Nëse fëmija yt është i sëmurë ti mundohesh sa më shpejtë ta dërgosh të mjeku për shërim,nëse e sheh se mjeku i parë nuk mund ta shëron hulumton tjetrin kështu ti vepron prej mjekut e në mjek që ta shërosh fëmijën tënd sa më shpejtë. Mirëpo nëse fëmija yt e lenë namazin ti nuk përkujdesesh fare( ta shërosh) sepse ti interesohesh për së tepërmi që fëmijës ti sigurosh ardhmëri vetëm të kësaj bote,e nuk interesohesh ti sigurosh ardhmëri në botën tjetër. Nga kjo themi se ti plotësisht ke harru programin e Allahut.

### **MËKATI I NJERIUT DHE MËKATI I SHEJTANIT**

Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: Pasha Madhërinë Tënde o (O Zot) do t'i përvetësoj dhe do ti mashtroj që të gjithë , përpos atyre që prej mesit të tyre janë robër të sinqertë (ndaj teje) Po ashtu ka thënë : Dhe ka kundërshtuar Ademi Zotin e Tij e ka rrëshqitë në mëkat dhe devijoi(nga rruga e drejtë). Pastaj Zoti i tij e zgjodhi atë ,ia pranoi pendimin dhe e udhëzoi .

Po ashtu ka thënë :Dhe Ademi mësoi fjalët se si të kërkonte falje prej Zotit të tij( e u penduar) ashtu që Ai ia pranoi pendimin .Parashtrohet pyetja:Pse Zoti i Lartmadhëruar Ademit ia ka pranuar pendimin,ndërsa Iblisin e ka mallkuar dhe e ka dëbuar nga mëshira e

Vet deri në ditën e kijametit?

përgjigjja: Mëkati i shejtanit ndryshon nga mëkati i njeriut. Shejtani ka bërë mëkat ndaj Allahut, kur ka refuzuar t'i bie në sexhde Ademit, pra ky ka qenë veprimi i tij ka qenë mëkat.

Ndërsa Ademi ka bërë mëkat ndaj Allahut kur ka ngrënë frytet e pemës, ky veprim ka qenë mëkat. Mirëpo që të dy këto mëkate kanë dallim të madh nga njëri-tjetri. Kur shejtani ka kundërshtuar, është tregu kryelartë dhe arrogant ndaj Zotit të Lartmadhëruar, dhe ka insistuar në mëkatin e tij duke thënë: „Do t'i devijoj ata në tërësi“. Ai ka sfiduar, dhe ka vazhduar të sfidojë pandërprerë, ai ka refuzuar të pranojë se ka bërë mëkat por ka kthyer urdhrin prapë të Zoti i Lartmadhëruar. Ndërsa sa i përket Ademit a.s. kur ka gabuar e ka pranuar gabimin e tij dhe është penduar, dhe nuk ka insistuar në atë që ka bërë, por ka thënë: „O Zoti im, unë jam njeri i dobët, më ka mashtruar dhe më ka devijuar shejtani, ai më ka poshtëruar, O Zoti im unë jam i vetëdijshëm se me të vërtetë Ti je në drejtë, fjala jote është e drejtë programi dhe rruga jote është e drejtë, por qenia ime është e dobët, nuk mundi ti qëndroj dhe gaboj e, Unë kthehem te Ti O Zot i im, i penduar, i përkulur duke kërkuar falje.

Pra kjo ka qenë rruga e Ademit, e ka pranuar Madhështinë e Allahut e ka pranuar peshën e mëkatit të vet, është penduar, dhe ka premtuar se nuk do të kthen më në atë mëkat. Krejtësisht ndryshe nga kjo ka vepruar Iblisi, ai nuk ka pranuar pendimin, por ka insistuar në mëkat, dhe ka këmbëngulur se ai është në të drejtë dhe se ai nuk ka gabuar, ia ka kthyer urdhrin Allahut, dhe se vepron si do ai, dhe se ai (Iblisi) ka të drejtë. Për këtë arsye e ka dëbuar Allahu nga mëshira e Tij. Por Iblisi me çka është pajtuar me këtë dëbim?

Është pajtuar me sfidimin e tij kur ka thënë:

„Pasha Madhërinë tënde (O Zot) do ti devijoj dhe do ti përvetësoj ato që të gjithë“. Mirëpo edhe ai gjatë kundërshtimit, prapë e ka ditë se urdhri i Allahut do të ketë sukses. Për këtë arsye ka thënë: „Pasha Madhërinë (Fuqinë) Tënde "E ka përdor termin „Fuqinë“ sepse Allahu është i pavarur për gjithçka nga gjithë bota. Iblisi i mallkuar i Zotit pra është përbetuar në pavarësinë e Allahut ndaj çdo gjë, dhe në panevojshmërinë e Allahut ndaj krijesave, dhe nuk ka has në diçka tjetër për t'u afruar njerëzve përpos fuqisë së Allahut, Krijues të tyre i cili nuk ka nevojë për ta. Po të kishte dashur Allahu i Lartmadhëruar që krijesat të nënshtrohen vetëm Atij të udhëzuar vetëm në rrugën e Tij shejtani nuk kishte pasur mundësi kurrë t'iu afrohet krijesave të Allahut. Për këtë ka përdorur formën përjashtuese kur ka thënë: „Përpos atyre (që në mesin e tyre) janë të sinqertë“. Pra atë që Allahu e do, e zgjedh që të jetë rob i sinqertë i tij. Iblisi te ai kurrë nuk mund të depërtoj.

## **SEXHDEJA DIKUJT TJETËR POS ALLAHUT**

Zoti i Lartmadhëruar thotë: Dhe kur ne u kemi thënë (i kemi urdhëruar) melaqet bini në sexhde Ademit, ata i ranë në sexhde, përpos Iblisit (i cili) refuzoi, refuzoi dhe ishte prej mohuesëve.

Pse ti bëhet sexhde dikujt tjetër pos Allahut, e pse Iblisi me qenë pabesimtarë, pse nuk i ka ra në sexhde Ademit, kur dihet Ademi është krijesë e Allahut?

Përgjigjja: Shejhi Shaëraviju përgjigjet:

Për arsye se urdhri për sexhde Ademit ka ardhur prej Allahut të Lartmadhëruar në mënyrë të drejtpërdrejtë te melaqet. E urdhri i Allahut është çështje obligative, ai patjetër duhet të ekzekutohet, pa pyetur e pa diskutuar fare, dhe pa analizuar. Urdhri ka qenë për

melaqet ,edhe për Iblisin për t'i ra në sexhde Ademit sepse ky urdhër ka qenë praj Allahut i cili në të njëjtën kohë është Krijues edhe i melaqeve ,por edhe i Ademit.

Urdhri prej Krijuesit është urdhër i cili duhet të zbatohet dhe realizohet. Iblisi ka mohu pse ka kundërshtuar urdhrin e Krijuesit të tij dhe ka insistuar dhe ka këmbëngulë në mëkatin dhe kryeneçësinë e tij.

### **MUSLIMANI EMIGRANT (REFUGJAT)**

Cilat janë obligimet e muslimanit emigrant në vend joislam i cili ballafaqohet me kushte dhe rrethana të reja,dhe si duhet t'i tejkalojë vështirësitë të cilat e rrethojnë për të u mos infektuar më sëmundjet e terimit të ri?

përgjigjja: Ndonjëherë ,kushtet e jetës e detyrojnë njeriun që të kalojë në një vend tjetër,e aty pas një kohe me ardhur në aso pozite ku njeriu,nuk mund të shpëtoj veten kurrsesi nga dukurit negative të atij vendi të ri,edhe nëse e harxhon tërë potencialin dhe tërë energjinë e tij.

Prej tyre p.sh. fëmijët e tij e mësojnë gjuhën e huaj dhe e harrojnë gjuhën e tyre arabe ,pastaj harresa e fesë së tyre dhe mosnjohja e vlerave të islamit, po ashtu edhe problemi pasi që të rriten vajzat. Ne mendojmë se nuk ekziston asnjë domosdoshmëri në jetë , e cila e shtyn njeriun të shkojë në një vend të pasigurt për fenë e tij dhe fenë e fëmijëve të tij. Posaçërisht shkuarja në një ambient i cili ua sjellë në pikëpyetje fenë e tyre dhe ku ai është i vetmi shpëtimtarë i tyre në ato vende në ato kushte dhe në ato rrethana.

### **VEPRIMI PARALEL ( I NDËRSJELLT)**

Pse Islami ka lejuar që muslimani të martohet me pasuese të librit(krishtere jehude)ndërsa nuk e lejon që muslimanja të martohet me pasues të librit. A nuk është veprim jo paralel apo joreciprocitet?

Përgjigjja:Mashkulli (burri) sipas natyrës së tij në çdo shoqëri është mbizotërues dhe udhëheqës i familjes. E nëse është musliman ai vepron sipas ligjeve të fesë së tij,ai e do bashkëshorten e tij,e nderon dhe e respekton,e nëse nuk e do, së paku nuk i bën padrejtësi,sepse atë çka e ka emanet dhe emanetin të cilin e ka marrë e bënë që jeta bashkëshortore në mes tyre të jetë e qetë,dhe me respekt të ndërsjellët. Përpos kësaj burri i cili e ka marr pasuesen e librin e beson pejgamberin e saj,ndërsa ajo nuk e beson në pejgamberin e tij,dhe nga kjo rezulton që femra e cila gjendet nën kurorën e burrit i cili beson në pejgamberin e saj është prioritare dhe më e mirë se femra e cila gjendet nën kurorën e burrit i cili nuk beson në pejgamberin e saj.

### **ARDHMËRIA E SUKSESSHME**

Duke përdor mjetet e medicinës bashkëkohore si p.sh preparatet e veçanta , preparatet e zërimit ,me të cilat mund të shihet (kuptohet) shtatzënia e hershme ,pa i përdor preparatet e rëndomta të cilat konstatojnë embrionin e zhvilluar jonormalisht p.sh femra e pa krah,pa kokë ,apo pa një pjesë tjetër të trupit.

Pyetja është: A lejohet që mjeku të bëjë abortimin , për të mëshiruar , për të siguruar shoqëri të ardhshme të shëndoshë e jo me të meta?

Përgjigjja: Në lidhje me këtë çështje i nderuari Shejh Shaëraviju thotë:AI i cili tenton të rregullojë një mjet vet mjeti është i rregulluar edhe vet është ai i cili çka ka në dorë e shkatërron në vend se të rregullohet vetë. Mjeti nuk është në dorën e tij ,ai ka për qëllim

paaftësinë në te,që do të thotë: Ai i cili dëshiron të krijoj njeri të verbër ,ai ka pasur dëshirë dhe qëllim që ashtu të krijohet, njësoj edhe i pakrahi, dhe pakëmbi ashtu ka dashur vet krijuesi i tyre. Kjo nga shkaku se në këto çështje Krijuesi dëshiron t'ua tërheq vërejtjen të tjerëve!!!

Kam thënë edhe më parë se: Ti nuk di vlerën e shikimit dhe begatave tjera që Allahu t'i ka dhënë përderisa nuk e sheh të verbrin ti nuk e falënderon Allahun, apo me fjalë tjera nuk kujton të mirën e Allahut për këmbët e tua sa nuk sheh njeri të çalë.

Ndoshta për këto çështje i ka krijuar Krijuesi ti thua se janë të zymta (jo të përkryera) është e vërtetë se janë të zymta por është zymtësi e përkohshme ,ndërsa tërësia është përsosmëri, ashtu që të gjithë njerëzit të përqendrohen dhe t'i kuptojnë të mirat e Allahut. ndërsa çështja se ti thua se do të jetë me të meta ,kjo mund të thuhet vetëm për çështjet të cilat i thua ti , p.sh. Nëse ti prodhon dritare ,por dritarja nuk ishte e përforcuar,e ti mund ta përforcosh ,por sa i përket Allahut. Allahu është më i lartë se ti. Ai ashtu e ka krijuar e ti mos thuaj :Kjo është me të meta , mos shiko sipërfaqësisht dhe me mendjelehtësi. ti nuk mund të dish urtësinë e krijimit të kësaj bote. Për ta sqaruar më mirë themi : Njerëzit me aftësi të kufizuara janë shumicë apo pakicë? Natyrisht se ato janë pakicë!! Ato janë mjet i sqarimit të gjithësisë!! Parashtrohet pyetja :Pse?

Për atë se Allahu dëshiron t'ia tërheq vërejtjen njeriut për ato begati,e pastaj prej mendjes së njeriut rezulton se ato janë çështje automatikisht të kategorizuara. Që do të thotë se mashkulli dhe femra i bashkojnë vezoret dhe mashkullorët e tyre dhe kështu merr fund. Ne themi Jo. Aty ka fuqi edhe më të lartë se kjo! Argument për këtë kemi se nëse të gjitha elementet janë të gatshme ,të njëjta ,mirëpo më vonë shohim se një njeri është në këtë formë,e një njeri tjetër në formë tjetër? Shkolla Gjermane e lashtë e quajtur shkolla Xhibil dhe shkolla *Bahter* kanë thënë: Paaftësitë (njerëzit me aftësi të kufizuara) në gjithësi janë argument se nuk ka Zot i cili paraqitet me urtësitë e tij, me përsosmëri të tij. Ndërsa shkolla bashkëkohore e cila është trashëgimtare e shkollës së mëhershme thotë: Mospaaftësia në gjithësi janë argument se ligjet janë ata të cilët mbizotërojnë gjithësinë se përndryshe edhe nga njëra anë por edhe nga ana tjetër ligjet në natyrë do të kishin qenë të çrregulluara dhe do t'kishte qenë gjithësia kaos.

E para: Çrregullia (disharmonia) është argument i mohimit të Zotit.

E dyta: Rregullsia (harmonia) është argument i mohimit të Zotit.

Që të dy shkollave u themi: Ju jeni të palogjikshëm .Nëse ka të meta ,parregullsi ,atëherë kjo është argument se ka fuqi edhe më të madhe se ato ligje,për këtë arsye edhe ligjet mund të ndryshojnë. Kjo argument veç është evident ,ekzisto,por është evident vetëm në disa njësi , pra është i pjesshëm. Nëse ka harmoni ,rregullsi , po ashtu edhe harmonia dhe rregullsia ekziston,mirëpo ekziston në çështje kryesore.

Nuk ka parregullsi dhe të meta ne thelb të çështjes,sepse parregullsia dhe disharmonia në thelb e shkatërron gjithësinë në tërësi. Për këtë arsye ne nuk mund të shohim disharmoni në qiell ,në tokë , në planete etj. etj. mirëpo e meta ekziston në individ. nëse një njësi apo individ ka të meta ,njësia apo individi tjetër nuk ka të meta!! për këtë arsye themi: O ju të cilët dëshironi të meta ,paaftësi ky është argument se ekziston një fuqi më e madhe se ato ligje. Kjo veç është evidente mirëpo vetëm në njësi , pjesërisht. E ju që dëshironi harmoni stabile ,edhe kjo është evidente mirëpo vetëm në çështjet e përgjithshme i cili po ashtu është argument i urtësisë së Krijuesit.

Përderisa një mendim shkon në drejtim të çrregullsisë dhe disharmonisë ,ndërsa mendimi tjetër shkon në drejtim të rregullsisë dhe harmonisë. ne u themi se që të dyja janë evidente. Mirëpo në vend se të ekziston disharmonia ne ligjin e përgjithshëm ,e që gjithësia të çrregullohet në tërësi , çrregullsia ekziston vetëm në disa pjesë ,dhe pjesërisht.

Atyre të cilëve dëshirojnë dhe pyesin për abortin apo heqjen e një shpirti u themi:Në vend se të bëhet abortimi ,apo hjekja e shpyrtit,e arritur shkencore e medicinës është që ta shëndoshë dhe ta rregullosh para se të lind i paaftë ,ndërsa mbytja është proces negativ ,e ti nuk ke bë asgjë!!

Ai i cili dëshiron që ta mbytë të paafti ,ai nuk e ka kuptuar urtësinë e ekzistencës. natyrshmëri e jona është se nëse dëshirojmë t'ia ushtrojmë apo trajnojmë një pjesë të shoqërisë për diçka,atëherë p.sh. trëndafilin e këpusim e pastaj ua shpjegojmë dhe ua sqarojmë.

Përfundim i kësaj është që ai i cili dëshiron të arrij të arritura shkencore për krijesën njeri,jo ta mbytë këtë , por të hulumtojë si ta pengoj shtrembërimin ,të metën dhe dobësinë e embrionit.

### **MËSHIRA E PALOGJIKSHME (CORODITUR)**

Pyetja:A lejohet dhurimi i pjesëve të trupit?

Përgjigjja: Ti jep një pjesë të trupit njeriut , ndërsa vetes ia hequr. Që nga momenti kur e ke hequr një pjesë nga një njeri për ta vendos tjetrit, ajo pjesë mund t'i përshtatet njeriut, e mund edhe të mos i përshtatet. Në këtë mënyrë , ti ke hequr një pjesë prej trupit tënd të cilën nuk dihet a e pranon trupi tjetër apo jo. Për këtë arsye unë e shoh se kjo është mëshirë e palogjikshme(e çoroditur).Këtë e ka krijuar Krijuesi ,të meta në krijesa ,paralizim në pjesë të trupit dhembje në një trup tjetër. Të gjitha këto tregojnë se ekziston një fuqi Madhështore. Për këtë arsye njeriu është më afër Zotit atëherë kur i mungon diçka prej pjesëve të trupit të tij.

### **OBDUKSIONI**

Pyetje:Cili është qëndrimi i islamit ndaj obduksionit?

Përgjigjja: Nëse obduksioni na ndihmon për diçka nuk ka kurrfarë pengese të bëhet.

### **TË DJEGURIT E KUFOMAVE**

Pyetje: Çfarë qëndrimi ka islami për djegien e kufomë?

Përgjigjja: Djegia e kufomës është haram,me zjarr dënon vetëm Allahu. Diçka çka e kanë pranuar në natyrë ashtu duhet ta lë në natyrë. Ndërsa sa i përket mendimit se djegia e kufomave pengon përhapjen e sëmundjeve të ndryshme nuk jan mendime të islamit ,dhe nuk ka të bëj islami me mendime të tilla.

### **SHOKËT E XHENETIT**

Pyetje: Cilat vepra të ngritin në shkallë të lartë të xhenetit dhe që të bënë të jesh në shoqëri të Muhamedit s.a.v.s ne xhenet?

Përgjigjja: Për të qenë shok i të dërguarit të Allahut s.a.v.s. në xhenet duhet të pasosh atë në çdo veprim,dhe të kesh shëmbëlltyrë të jetës tënde,dërgo salavate për te , duaje atë,sepse kush e do një njeri (popull) Allahu e ringjall më atë njeri(popull).Mund të falesh edhe nafile sa ke mundësi ,në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje ,por mos me

ngarkuar veten se Allahu nuk ngarkon askënd ,por sa ke mundësi. Ta dish ,nëse ke falë nafile ke rezervuar (ke përgatitë) ashtu që nëse pastaj sëmuresh apo të pengon diçka në namaz , Allahu t'i vazhdon shpërblimet e veprave nafile të cilat i ke krye gjatë gjendjes fizike të shëndoshë,dhe kur ke pasur mundësi ,Allahu t'a mundësoftë dhe t'i realizosh dëshirat tua.

### **EZANI DHE CËSHTJET RRETH TIJ**

Është bërë traditë në shumicën e xhamive kur muezini e thirrë ezanin menjëherë pas përfundimit thuhet me zë: „ESELAMU ALEJKE JA SEJIDIJ JA RESULULLAH". Pra salavatet për të dërguarin e Allahut s.a.v.s me zë pas ezanit a është pjesë përbërëse e ezanit, apo kjo është shtuar më vonë. Ju lutemi të na sqaroni?

Përgjigjja: Kjo është respekt dhe dashuri ndaj të dërguarit të Allahut s.a.v.s mirëpo t'i e do me entuziazëm.Muhamedi a.s. ka thënë:Kur të dëgjoni muezinin, dhe ai përfundon ezanin thoni ashtu siq thotë muezini, pastaj më dërgoni salavate mua.(Pra edhe muezini edhe dëgjuesit e ezanit) dërgojnë salavate për të dërguarin e Allahut s.a.v.s në heshtje. Mirëpo muezini këtë nuk duhet ta bëjë me zë të lartë sikurse të ezanit,sepse ndokush prej njerëzve mund të mendoj se është pjesë përbërëse e ezanit dhe tekst i ezanit.

### **PSE QUHET RAMAZAN**

Pyetje: Pse Zoti i Lartmadhëruar muajin e agjërimit e ka quajtur Ramazan ,çka do të thotë Ramazan,dhe cila është urtësia e agjërimit. Shpresojmë se do t'na sqaroni këtë çështje n e lusim Allahun t'ju shpërblejë për këtë!

Përgjigjja: Kur Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“(Ato ditë të numëruara janë) Muaji i Ramadanit që në te (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfytes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtria). E kush e përjeton prej jush këtë muaj le të agjërojë, ndërsa kush është i sëmurë ose në udhëtim, le të agjërojë aq ditë nga ditët e mëvonshme. All-llahu me këtë dëshiron lehtësim për ju, e nuk dëshiron vështirësim për ju. (Të agjëroni ditët e lëshuara më vonë) Që të plotësoni numrin, ta madhëroni All-llahun për atë se u udhëzoi dhe që të falënderoni”.

(*EL-BEKARE, 185*)

Çka do të thotë (shehr)muaj?Fjala muaj ka prejardhjen prej fjalës ,lajmërim ,proklamim dhe paraqitje .Edhe sot përdoret kjo fjalë me këtë kuptim në raste të aktmarrëveshjeve kur themi:Esh-shehr (muaji) i aktit. Pra lajmërim se u bë marrëveshje që të mos ndodh kontratë mbi kontratë. Gjatësia apo hapësira kohore quhet muaj(shehr) sepse është koja e sinjalit në të cilin ti e lajmëron apo paraqet .

Dielli nuk ka mundësi të tregoj kohën ,por është shenjë me të cilën identifikohet dhe përcaktohet dita. Dita është prej lindjes së diellit e deri në lindjen e tij herën tjetër. Kjo ditë përfshinë edhe ditën edhe natën. Dielli nuk ka ndonjë shenjë dalluese paraqitëse në bazë të së cilës e kupton njeriu,mirëpo sa i përket hënës së re në fillim të muajit pas kalimit të saj në faza dhe forma të ndryshme dallohet dhe paraqitet saktësisht në formë krejtësisht të re. Pra te hëna e re ka shenjë dalluese të muajit ,atëherë hëna e re është për tu dalluar muajin ,ndërsa dielli është për të dalluar ditën prej ditës.

Për këtë arsye Zoti i Lartmadhëruar ka ndërlidhë veprimtarinë e adhurimit me shenja të qarta. Në këtë rast shenjë e qartë është hëna e re. e pas kësaj vjen shenja tjetër e ditës e ajo shenjë është vetëm dielli. Sepse hëna e re nuk është shenjë e ditës ,pra nuk sjell

ditën.Pra ne kemi nevojë për të dy shenjat .E kjo do të thotë se hëna e re pas rrotullimit është fillimi i muajit.Për këtë arsye koha e Ramazanit fillon natën. E adhurimi i Ramazanit fillon natën ,pasi që nata vjen e para ,kur të filloj errësira e natës ,e nëse e shohim hënë themi :Muaji i Ramazanit ka fillu.Kjo çështje nuk sjell diskutim se dita është para natës,përpos në një lloj të adhurimit,e ai është qëndrimi në arafat ,e pas tij vjen nata. Muaji i Ramazanit tregon nxehtësinë dhe ndezjen (Kur thuhet Remeda insan-do të thotë u ndezë njeriu nga etja). Ramada-rëra e nxehtë. bagëtia Remedat, do të thotë : E ka kapluar nxehtësia ,dhe është dobësuar aq shumë sa që nuk mund të ngritet në këmbë. Pra thelbi i fjalës është nxehtësi dhe uri e madhe .Që do të thotë se njerëzit kur i kanë emëruar muajt , muajin e nxehtësisë e kanë quajtur muaji i Ramazanit(nxehtësisë). Pra ato e kanë vërejtur se cilësimi i muajve dhe emërimi i tyre në momentin e emërimit të tyre është bërë në bazë të kësaj çështje dhe është zëvendësuar kalendari i posaçëm arab hënor në atë të përgjithshëm diellor. Pastaj ka ardhur muaji i Ramazanit në kohën e ftohtë të pranverës .Mirëpo në momentin e emërimit ka qenë nxehtësi .Pra Ramazan është quajtur në kohën e pikënisjes ,apo fillimit në të cilin ka qenë nxehtësi e madhe .Ashtu Zoti i Lartmadhëruar e ka zgjedhur këtë muaj më këtë emër për të tregu vështirësinë me të cilën ballafaqohet agjëruesi.

### **DITË TË CAKTUARA**

Pyetje: Cila është urtësia e agjërimit të ditëve të caktuara dhe cili është kuptimi i ditëve të caktuara?

Përgjigjja: Agjërimi i ditëve të caktuara është dita Ashura dhe tri ditë të çdo muaji etj. Këto ditë të caktuara dhe definuara janë të cilat Allahu i ka caktuar për t'i agjëruar, përpos kur njeriu është i sëmurë ,apo në udhëtim ,mirëpo këto ditë të caktuara nëse mundet të agjëroj ,por agjërimi e rraskapit ka të drejtë ose të agjëroj ose ti kompensojë me sadaka. Zoti i Lartmadhëruar thotë:

Mirëpo kur Zoti i Lartmadhëruar ka sjell vendimin për endimin për agjërimitin e muajit Ramazan,nuk ka dhënë leje ,apo nuk ka lejuar që të bëhet zgjedhja mes agjërimit apo kompensimit ,argument për këtë kemi se Zoti i Lartmadhëruar nuk e ka tregu në ajetin:

EL

### **BEKARE**

Për këtë arsye ne themi se agjërimi ka kalu në dy faza ,faza e parë kur Zoti i Lartmadhëruar e ka obligu agjërimitin në ditë të caktuara kush nuk ka qenë i sëmurë dhe nuk ka qenë në udhëtim ai ka pas obligim të agjëroj e pas kësaj nëse agjërimi e ka lodh apo e ka mundu ,ai ka pas të drejtë të agjëroj ose të kompensojë edhe nëse agjërimi ka qenë i dobishëm për të. Mirëpo kur ka sjell vendim ,që të agjërohet saktësisht muaji i Ramazan nuk e kanë pas *këtë të drejtë dhe këtë lehtësim*. Argument për këtë e kemi,se pjesa e tekstit „i mundon" është vendos në ajetin,„ditë të caktuara" dhe nuk ekziston në „Muaji i Ramazanit është muaji në të cilin ka zbrit Kur'ani.....Dhe kush është prezent në këtë muaj le të agjëroj e pastaj nga agjërimiti është përjashtuar i sëmurë dhe udhëtari. VALLAHU EALEM.

## ALLAHU DËSHIRON T'U LEHTËSOJ JUVE E NUK DËSHIRON T'U VËSHTËRSOJ

Pyetje: Çka nënkuptohet prej ajetit fisnik: Allahu dëshiron për ju lehtësim e nuk dëshiron për ju vështirësim?

Përgjigjja: Disa njerëz ndiejnë vështirësi gjatë adhurimit .Ne atyre u themi: Vështirësia te ai i cili adhuron dike është para vështirësisë së adhurimit. Shiko Zoti i Lartmadhëruar çka ka dashur t'na thotë: Allahu dëshiron për ju lehtësim ,e nuk dëshiron për ju vështirësim"

Vazhdimësi dhe sqarim se Allahu i Lartmadhëruar e ka liruar të sëmurin dhe udhëtarin prej agjërimit. Vërtetë Allahu dëshiron për ju lehtësim. Me këtë ka dashur të na tregoj,se nëse e kundërshton,ti ke dashur që Allahu të të vështirësojë , e jo të të lehtësojë. ti patjetër duhet të përmbahesh ajetit: Agjëro po aq ditë në ardhmëri"(në kohë tjetër") .E ti duhet t'i përmbahesh lehtësimit (mosagjërimit) .Parashtrohet pyetja: pse? Sepse nëse ti i përmbahesh dispozitës së agjërimit në atë gjendje (udhëtim e sëmurdje) ti ke vendos për vete dispozitën e vështirësimit ndaj vetes.

### NDERIMI I TË VDEKURIT

Pyetje: Varrimi i të vdekurit në tokë a mos është nënçmim për ta?

Përgjigjja: varrimi i të vdekurit në tokë është nderim për ta. Sepse dheu është burimi i përbërjes së tij. Për këtë arsye unë sfidoj „Ai i cili e do njeriun e vdekur le ta kthej në bazën e tokës një dit ,dy ,një javë....! Për këtë arsye më i dashuri i të vdekurit le të angazhohet për ta varrosur të vdekurin në dhe,sepse ne kështu e kthejmë te nëna tokë,e cila ia merr të gjitha elementet e të vdekurit , e përkëdhel dhe e pranon në gjirin e saj me të gjitha elementet!!

Është interesant se ne nëse e vendosim të vdekurin drejtpërsëdrejti në tokë ,toka i pengon erërat e rënda të dalin prej tij,por nëse e vendosim në çdo vend tjetër kundërmon erë e rëndë. kështu pas një kohe të gjatë zhduken elementet e tjera ,për t'i lënë hapësirë që të kenë dobi elementet tjera. Të vendosurit e të vdekurit në tokë është nderim për ta , po t'kishte qenë ndryshe kurrë nuk do ta kishim vendosur të dashurin tonë në dhe ,provoje vendose në dhe *a do të kishim duruar* ,nuk do t'kishim duruar ,ai do të kthehet në tokë prapë. Ai është prej dheu dhe në dhe do të kthehet. Prej saj ju kemi krijuar ,në te do t'u kthejmë ,dhe prej saj do t'ju nxjerrim edhe herën tjetër.

SADAKALLAHUL

### ADHIJM

Ajo çka e mbron jetën tonë është lëvizja dhe aktiviteti jonë mirëpo njeriu kur të vdes nuk mund të lëviz ,por vetëm nëse e lëviz tjetri po sepse ai është shndërruar në kufomë. Allahu dëshiron që këto të meta (paaftësi) të njeriut t'i mbuloj nga njerëzit tjerë që forma e njeriut të vazhdoj (mbetet) e gjallë.,pra të ketë gjallëri në vazhdim ,dhe që ne mos të dimë çka ndodhë pas vdekjes së tij. Këtë na ka ilustruar me shembullin e Habilit dhe Kabilit kur sorra e ka varrosë sorrën ,që edhe ai ta varros vëllanë e tij,sepse çdo gjë çka rezulton prej të vdekurit është turpëri ,sepse njeriu pastaj neveritet prej kufomës ,dhe pjesët e trupit të gjallë lëngojnë .me një fjalë varrimi i të vdekurit nën dhe është nderim për te ,që njerëzit dhe të dashurit e të vdekurit të mos lëndohen.

### BOTA E NURMAVE DHE BOTA E EKZISTENCËS

Pyetje: A i tubon Allahu i Lartmadhëruar bilionë njerëz në ditën e Kijametit në një vend ,në një kohë. I nderuar Shejh mos ma zënë për të madhe . Në cilin vend ,në cilën kohë , lus Allahun t'na falë. Mendja ime nuk mund ta paramendoj një gjë të tillë. Është mahnitëse ,po unë jam i dyshimtë në te. Imami i nderuar më shikoi në ,fytyra e tij shkëlqeu dhe tha:Zoti të bekoftë.

E nderuara pyetëse , bija ime e nderuar .Ti nuk mund ta paramendosh madhësinë e gjithësisë. Toka është planet prej njëmbëdhjetë planetëve të sistemit diellor,ndërsa sistemi diellor është një prej një milion sistemeve sikur të sistemit diellor. E gjithë kjo është vetëm qielli i kësaj bote. Po,çka janë qiejt dhe toka ,dhe gjithçka ka mes tyre për fuqinë e Allahut,përpos sikurse një farë të cilën e hedh bujku në arë.

Astronomia na mundëson që të kuptojmë më lehtë sepse ka gjet masën e gjatësisë së dritës ,për t'na zvogëluar numrat marramendës në mendjen tonë. Kurrë nuk mundemi me paramenduar madhësinë e krijesave të Allahut të Lartmadhëruar. Në momentin kur ti e përkufizon gjithësinë në planetin e tokës ,kjo i ngjason sikurse ti me konsideruar gjithësinë sikurse një ndërtesë në të cilën banon ti apo sikurse një rrugë në të cilën ecë ti,apo sikurse një qytet në të cilin jeton.

### **ATË DITË KUR NJERIU IKË PREJ VËLLAUT TË TIJ**

Pyetje:Pasi që njeriu në ditën e kijametit ikë prej vëllait të tij e nënës e babës së tij, ku i ka shkuar ajo dashuri të cilën e ka pasur ndaj babës nënës e vëllait?

Përgjigjja:Allahu ka dëshiruar që t'na sjell shembull se njeriu e ka veten e vet. Kjo vetvete e bën që dashuria të jetë në atë çka më së shumti i sjell të mira dhe i bën dobi .

Për këtë arsye dashuria e djalit ndaj nënës nuk rezulton vetëm në atë se e ka nënë. Argument për këtë e kemi se fëmija largohet nga nëna dhe gji i jep një grua tjetër e edukon gruaja tjetër, përkujdeset dhe e rrit një grua tjetër, ai fëmijë nënën e vet nuk e njeh dhe nuk e do por e do atë e cila e ka dashur dhe e ka ledhatuar. Allahu i Lartmadhëruar dashurin reciproke nënë babë fëmijë e ka bë varësisht prej nevojës dhe rrethanave. Për këtë arsye kur është pyetur një grua beduine për dashurinë ndaj fëmijëve të saj është përgjigjur:Ë dua më së shumti fëmijën më të voglin deri sa të rritet,të sëmurin deri sa të shërohet dhe të zhdukurin deri sa të gjendet. Pra dashuria varësisht prej rastit dhe nevojës. Në ditën e kijametit për besimtarët të cilët kanë bë vepra të mira nuk do të jetë kështu. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë: „Ata të cilët kanë besuar e edhe pasardhësit vazhdojnë në përforcimin e besimit , ne ua bashkëngjisim atyre pasardhësit e tyre. Ndërsa ata të cilët do të ikin nga familja e tyre jan ata të cilët kanë bë mëkate dhe e kane hidhëruar Allahun e Lartmadhëruar ,dhe ato do të dënohen ,atëherë secili do të jetë i preokupuar me fatkeqësinë e vet. Ata ikin për shkak të pabesimit ,për shkak të mëkateve,prej atyre të cilët kanë qenë shkak i mosbesimit dhe mëkateve.

### **SHPËRBLIMI DHE DËNIMI**

Cila është urtësia e shpërblimit dhe dënimit në bazë të ligjit të Allahut. Dhe a shpërblehet njeriu në këtë botë ,para botës tjetër, po ashtu a dënohet para botës tjetër. Nuk ka dyshim se në këtë ka arsye dhe urtësi .Lusim Imamin e nderuar të na sqaroj këtë?

përgjigjja: Dua të pyes pyetësin: A e shikon jetën e saj në aspekt të veçantë , dhe jetën e saj në përgjithësi e tu thotë njerëzve çka mendojnë për të. Nëse nuk jan të fesë sime e vendosin ligjet e tyre të shpërblimit dhe ndëshkimit për fëmijët e saj edhe pse ajo i do më shumë se çdo kush tjetër. Po ashtu edhe baba. Shteti parasheh ligjin e e shpërblimit dhe

ndëshkimit për qytetarët e vet. Pra çdo përkudjesës i diçkaje parasheh ndëshkimin dhe shpërblimin për atë. Përderisa kjo vajzë ka besuar se Allahu është Krijues ,atëherë është e logjikshme me qenë shpërblimet dhe ndëshkimet. Po mos t'kishte ekzistuar çështja e shpërblimit dhe ndëshkimit ,ne menjëherë do t'kishim parashtruar pyetjen për ta,sepse vet natyra ,dhe vet mendimet në këtë botë kanë vendos çështjen (ligjin) e shpërblimit dhe ndëshkimit. Të ekzistuarit e shpërblimit dhe ndëshkimit është domosdoshmëri përderisa të ekzistoj çështja e vullnetit ,dëshirës ,dhe zgjedhjes. Përderisa ti ke të drejtë të zgjedhësh të veprësh apo të mos veprësh patjetër duhet të ekzistoj edhe çështja të shpërblehesh ose të ndëshkohesh,sepse atëherë nuk kishte pas vlerë liria e të vepruarit. Përderisa ti je i lirë dhe i vullnetshëm patjetër duhet t'i bartësh rezultatet (pasojat) e zgjedhjes tënde. Nxënësi shkon në shkollë ,ai është i lirë të dëgjoj apo t ë mos dëgjoj ,të kuptoj apo të mos kuptojë,ai është i lirë të mësoj apo të mos mësoj. Ai gjatë tërë vitit është i lirë të zgjedhë. Po mos të ishte provimi në fund të vitit,kalimi e përsëritja asnjë nuk do t'ishite lodhur për të kuptuar, e për të mësuar gjatë tërë vitit. Pra të ekzistuarit e shpërblimit dhe ndëshkimit është garanci për mosdhurimin e të drejtës së vullnetit dhe zgjedhjes. Për këtë arsye nuk vendoset ligji i shpërblimit dhe ndëshkimit për çështjet në të cilat nuk ka të drejtë(pra çështjet e imponimit).Atëherë nuk ka çka të bëhet pyetja:Pse është ligji i shpërblimit dhe ndëshkimit ?Por përkundrazi,po mos të kishte ekzistuar shpërblimi dhe ndëshkimi pa tjetër do të ishte parashtruar pyetja:Pse mos të ekzistoj shpërblimi dhe dënimi?Qëllimi dhe arsyeja e të ekzistuarit të shpërblimit dhe dënimit ,nuk është që të kryhen veprat e ndaluara ,por që të mos ndodh që të kryhen ato. Kur unë them:Vjedhësi ndëshkohet me prerje të dorës,kjo nuk do të thotë se unë jam duke thënë:Vjedh që ta prej dorën ty. Por kuptimi i saj është se unë jam duke thënë:Kujdes ,mos vjedh se përndryshe do të pritët dora.

Pastaj shikojmë një njeri në jetën e tij është në rrugë të drejtë,i dobishëm për shoqërinë, nuk iu cenon të drejtën askujt ,ndërsa në anën tjetër një njeri tjetër krejt ndryshe prej tij. A do t'ishite drejtësi që këta dy të jenë të barabartë,njeriu i cili është degjeneruar vjedh e bën krime te të tjerët me njeriun e ndershëm dhe besnik?

Pra,pagimi bënë që jeta e njeriut në këtë botë dhe në botën tjetër të jetë peshoj dhe pikëbashkimi i ndarjes së njëres prej tjetrës. Nuk mund të jesh i lumtur në botën tjetër pa punuar vepra të mira në këtë botë. Nuk shkëputet puna e njeriut në këtë dynja prej pagimit në botën tjetër,që do të thotë jeta e tij është edhe në këtë botë edhe në botën tjetër. Kështu kur njeriu bënë një punë të keqe , ai do të jetë shëmbëlltë e mirë për të tjerët,nëse nuk ndëshkohet nuk pengohet dhe nuk ndërpritet hovi i tij

VALLAHU EALEM ALLAHU E DI MË SË MIRI

### **E ZGJËRON KRAHRORIN TIM**

Pyetje:Ndonjëherë kur falem më çlirohet edhe më zgjerohet gjoksi e ndonjëherë nuk ndiej kënaqësi fare në namaz. Kjo ndodhë pa dëshirën time .A ekziston diçka apo ndonjë këshillë , apo formë e cila më bënë që çdo herë të ndihem më i devotshëm dhe më i qetësuar në namaz?

Përgjigjja: Allahu i Lartmadhëruar dëshiron nga ne t'i kryejmë veprat obligative si p.sh namazin. nëse e kryejmë këto vepra me qetësi ,kjo do të thotë shpërblim i parakohshëm,mirëpo pse nuk ndien qetësi ,dhe zgjerim i kraharorit kjo nuk do të thotë që të mos falet namazi,përderisa ti vazhdimisht i kryen obligimet ,ti vazhdimisht do të shpërblehesh për veprat e kryera.

Është parim të cilin patjetër duhet ta dish se nuk do të japim përgjigjen për çështjet të cilat

nuk janë në dëshirën dhe kompetencën tonë. Njeriu i kryen gjithmonë namazet ,pa marrë parasysh a i zgjerohet gjoksi në namaz apo jo ,sepse namazi është obligim e lënia e namazit pabesim.

**PËRFUNDIMI I PJESES SË NËNTË  
DHE PASON PJESA E DHJETË.**